




AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

PLANI STRATEGJIK 2023 - 2028

I AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

PLANI STRATEGJIK 2023 - 2028

I AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

KREU I - KONTEKSTI I STRATEGJISË

I.1 Zbatimi i Planit Strategjik 2017- 2022.....	5
I.1.1 Sfida dhe rekomandime	7
I.2 Plani Strategjik 2023 – 2028.....	8
I.2.1. Objektivi i dokumentit.....	8
I.2.2 Metodologjia.....	8
I.2.3 Kuadri institucional.....	9
I.2.4 Kuadri ligjor.....	10
I.2.5. Ndryshimet e bëra në vitin 2022.....	12
I.2.6 Struktura e Autoritetit.....	13

KREU II - PLANIFIKIMI STRATEGJIK

II.1 Vështrim i përgjithshëm mbi Planin Strategjik.....	15
II.2 Qëllimet Strategjike, Objektivat specifikë dhe Masat për zbatimin e Strategjisë	17
II.3 Objektivat e Menaxhimit.....	32
II.4 Buxhetimi.....	34
II.5 Risqet potenciale dhe adresimi.....	36

KREU III - ZBATIMI, RAPORTIMI, MONITORIMI DHE LLOGARIDHËNIA

III.1 Institucionet përgjegjëse	37
III.2 Mekanizmat e monitorimit	38
III.3 Raportimi i progresit	38
III.4 Vlerësimi i progresit	39

KREU I - KONTEKSTI I STRATEGJISË

I.1 Zbatimi i Planit Strategjik 2017- 2022

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) u krijua me ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, unitetit dhe pajtimit kombëtar. Autoriteti është institucion i pavarur, përgjegjës për mbledhjen, administrimin, përpunimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe për sigurimin e aksesit në ta, për të gjitha subjektet e ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar, në funksion të edukimit të publikut dhe mbështetjes së vlerave demokratike të drejtësisë, së vërtetës, pajtimit dhe përgjegjësisë për gjeneratat e ardhshme.

Autoriteti u krijua në frymën e rezolutave europiane dhe shqiptare për domosdoshmërinë e dënimit të krimeve të komunizmit, në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut. Mbështetur në një plan strategjik 2017 -2022 ambicioz, me vizion të qartë dhe mision të përcaktuar, Autoriteti e ndërtoi punën e tij duke shërbyer si platformë e besueshme shërbimesh për individët dhe të interesuarit për akses në trashëgiminë e madhe të dokumenteve të ish-Sigurimit, që nga kërkesat individuale, institucionale, studimore e mediatike, te kërkesat për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblymi, për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit, burgimit apo për zbardhjen e bashkëpunëtorëve. Po ashtu, si burim i aksesueshëm dhe vital për të vlerësuar të kaluarën e Shqipërisë nën sundimin komunist.

Autoriteti ushtron funksionet e veta në ndërtesën e caktuar nga qeveria shqiptare, e rikonstruktuar dhe me kushte të përshtatshme pune për stafin e institucionit.

Grumbullimi i arkivit në një vend të vetëm është sfida e 5 viteve të para. Të gjitha materialet dokumentare që për vite kanë qenë shpërndarë në dy vendndodhje arkivore, janë përqëndruar në arkivin e Autoritetit dhe po sistemohen në mënyrën e duhur.

Institucioni ka marrë mbështetje të zgjeruar nga partnerët ndërkombëtarë që në hapat e parë, me projekte që e kanë ndihmuar të ngrihet, të rrisë kapacitetet, të plotësojë infrastrukturën e brendshme dhe digjitale e të çojë përpara nisma me rëndësi për pozicionimin e tij në skenën publike, si aktor i kujtesës.

Partnerë dhe donatorë mundësuan rikonstruktimin e ndërtesës dhe krijimin e një arkivi modern të digjitalizuar, projekt që u mbyll në 2022.

Autoriteti ka zhvilluar në zbatim të Strategjisë 2017 -2022: 65 mbledhje dhe 553 vendime, nga të cilat 506 vendime unanime, 2 marrëveshje bashkëpunimi, 397 kandidatë apo zyrtarë të verifikuar në 95 kërkesa institucionale, 452 aplikime individuale, 9 kërkesa për b.p të zbardhura, 344 kërkesa për qëllime rehabilitimi e dëmshpërblymi dhe për pajisjen me vërtetim për periudhën e internimit apo burgimit, 7 nga Ministria e Drejtësisë, 111 kërkesa studimore e mediatike me 461 dosje dosje të trajtuara, 63.128 fletë dokumente të deklasifikuar, të digjitalizuara 610 dosje fizike, 196 dosje të mikrofilmuara, në total 63 904 fletë të skanuara, 40.000 faqe, nga të cilat 12.000 të anonimizuara, vënë në dispozicion për individët dhe 74.175 faqe, ndër të cilat 16.337 faqe të anonimizuara, vënë në dispozicion për studiuesit.

Në total, që nga krijimi në 2017 e në mbyllje të vitit të pestë të punës, janë verifikuar gjithsej 2.189 kandidatë përpara emëritim/ngritjes në detyrë, si edhe kandidatë për t'u zgjedhur deputetë e kryetarë bashkish, ku 2.118 rezultojnë pa dokumente, ndërsa 71 kandidatë me dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

Deri në fund të vitit 2021 janë paraqitur gjithsej 2185 kërkesa individuale, 459 kërkesa studimore mediatike dhe 876 kërkesa për qëllim dëshmipërbliimi apo për vërtetim internim dëbimi. 24 marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar me partnerë brenda vendit dhe jashtë tij.

Sot, të gjitha vendimet e Autoritetit mbi kandidatët dhe zyrtarët e verifikuar, kërkesat individuale, institucionale, studimore dhe mediatike, publikohen periodikisht në buletinët e përdymuajshëm, në letër dhe në faqen zyrtare, si dhe shpërndahen gjerësisht online.

Aktivitete të rëndësishme u organizuan nga institucioni, i cili mori rol qendror në debatin publik për çështje të së shkuarës komuniste, si kampi i Tepelenës, të zhdukurit në komunizëm, artistët e shkrimtarët eurvejuar, emigracioni politik, ku me tryeza të rumbullakëta, konferenca, simpoziume shkencore dhe dialogë lokalë në mbarë vendin, arriti të pozicionohej mes institucioneve të kujtesës, me rol në të sotmen dhe të ardhmen e Shqipërisë.

Presidenti i Republikës, me propozim të Autoritetit, për disa vite rresht nderoi 13 figura të solidaritetit dhe dinjitetit njerëzor. Bashkia Elbasan, me propozim të Autoritetit, nderoi me titullin "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) Atë Josif Papamihalin, i zhdukur në kampin e Maliqit. Rruga "26 shkurti" në Mënik të Tiranës dhe Muzeu i Shkencave të Natyrës "Sabiha Kasimati" në Tiranë morën emërtimet përkatëse me propozime të Autoritetit.

Dy memorialë të punuar dhe zbatuar nga Autoriteti janë vendosur për herë të parë në dy vende kujtese, në Tepelenë dhe Maliq, aty ku deri më sot nuk kishte pllakatë informuese.

59 libra si dhe publikime online, ekspozita fizike dhe virtuale, dëshmi e dokumentarë, janë prodhuar nga Autoriteti, në bashkëpunim me partnerë, të cilët prezantohen në faqet online

të institucionit, që me vitet ka përshkallëzuar mundësinë për të arritur te brezat, shoqëria, publiku.

Materialet e hulumtuara janë përkthyer në anglisht për të ndërkombëtarizuar kauzat e ndërmarra dhe janë prezantuar në botë.

Tre faqe online administrohen sot nga Autoriteti, në vijim të projekteve të mëhershme,

Edhe muret kanë veshë, me dëshmi gojore, www.dosjet.gov.al, me profilet e të dënuarve politikë, kundërshtarë të sistemit, platforma e leximit ISSUU dhe rrjetet sociale, ku Autoriteti ka punuar për të qenë i pranishëm, i arritshëm dhe sa më afër të rinjve.

Veç përmasës tematike, edhe gjeografikisht, në Shqipëri e jashtë saj, në 5 vjet janë prekur tema në rëndësishme në Shkodër, Malësi të Madhe, Vermosh, Pukë, Burrel, Kurbin, Tiranë, Durrës, Elbasan, Lushnjë, Belsh, Savër, Gostimë, Berat, Korçë, Voskopojë, Maliq, Përmet, Tepelenë, Gjirokastrë, Himarë, Sarandë, Konispol. Po ashtu, është punuar me institucionet ndërkombëtare dhe diasporën shqiptare në SHBA, Belgjikë, Gjermani, Poloni, Çeki, Sllovaki, Bullgari, Hungari, Rumani, Estoni, Izrael.

Sot Shqipëria është pjesë e Rrjetit European të Institucioneve të ish-Policive Sekrete, dhe vijon të jetë e pranishme si anëtare vëzhgues e ENRS, ku ka integruar Ministrinë e Kulturës.

Partnerë aktivë të Autoritetit në vite kanë qenë Prezenca e OSBE në Tiranë, PNUD në Shqipëri, Bashkimi European, ambasada amerikane, gjermane, suedeze, zvicerane, italiane, polake, izraelite, ICMP.

Në 5 vjet, janë lidhur 24 marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe dhe organizata të kujtesës e të të drejtave të njeriut në vend dhe jashtë tij, duke e zgjeruar spektrin e veprimtarisë së Autoritetit, si me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurit Politikë, Institutin e Historisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike, Shërbimin Informativ Shtetëror, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Universitetin e Tiranës, Muzeun Kombëtar të Përgjimeve “Gjethi”, PERFORMShkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme, Zërin e Amerikës, Qendrën e Bashkëpunimit Ndërfetar. Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve Shkup, Fondacionin Kujto. al-Arkiva Online e Viktimave të Komunizmit, Muzeun Historik Kombëtar, Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), Qendrën MEMO, Universitetin European të Tiranës, Shoqatën “Tirana”, Akademinë e Studimeve Albanologjike ASA, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ëikimedians of Albanian Language User Group, Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë.

Po kështu, Autoriteti është mbështetur me dy projekte donatorësh, të cilat kanë rezultuar të sukseshëm dhe një përvojë shumë e mirë për të vijuar punën për ngritje fondesh edhe gjatë 5 viteve të ardhshme.

1. Financim nga Ambasada Suedeze për projektin “Prokurimi i rikonstruksionit të ndërtesës së AIDSSH-së dhe shërbimeve TIK, për krijimin e një arkive moderne”. Fondi i përgjithshëm 43,898,414.00 lekë.
2. Granti i financuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për projektin “Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për drejtësinë kalimtare dhe pajtuese, zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur gjatë periudhës komuniste” në vlerën 2,975,145 lekë.

Sot, Autoriteti e gjen veten me bilanc pozitiv sa i takon ndërtesës, arkivit, shërbimit të dokumentacionit, rolit në komunikimin publik, rritjes së ndërgjegjësimit për të zhdukurit në komunizëm.

I.1.1 Sfida dhe rekomandime

Mbetet shumë për të bërë për hapjen e plotë të materialeve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe jo vetëm, për qartësimin e fatit të figurave të stigmatizuara, nëpërkëmbura, të konsideruara “armiqtë e popullit” dhe të të zhdukurve.

Sfidat e radhës janë për kthimin e Autoritetit në institucion kujtuese, që përveçse zbërthen makinërinë e shtypjes, sjell edhe zërin e qëndrimin e viktimës, duke krijuar kuadrin e plotë historik të diktaturës.

Njëherësh, një qendër e vizitueshme, me mundësi leximi e njohjeje me dokumentacionin, po ashtu, një instrument që ndihmon për zbërthimin e së shkuarës dhe hetimin e fatit të viktimave të pagjetur. 5 vitet e para ishin themeli ku do të mbështetet një institucion i konsoliduar, me vizion të qartë për të nesërmen.

Për të ardhmen rekomandohet:

- Forcim i kapaciteteve institucionale nëpërmjet:
 - a) një përzgjedhjeje shumë të kujdesshme të burimeve njerëzore si për strukturën permanente ashtu edhe për ekspertizën lokale por edhe bashkëpunëtorët e Autoritetit, me të cilët bashkëpunohet në kuadër të projekteve/nismave apo aktiviteteve të caktuara;
 - b) Trajnimeve brenda dhe jashtë vendit të stafit, shkëmbimit të eksperiencave dhe transferimit të know-howit përmes vizitave të punës jashtë shtetit;
 - c) Zgjerimit të spektrit të bashkëpunimit me organizata homologe/partnere dhe Marrëveshjeve të Bashkëpunimit;
- Rritja e burimeve financiare për të mundësuar vizionin dhe objektivat strategjike të institucionit, nëpërmjet përpjekjeve të mbështetura në arësytetime dhe argumenta shterues për ç'ka kërkohet nga buxheti i shtetit, si dhe përpjekjeve për fund-raising donatorësh, për projekte me impakt afat-mesëm apo afat-gjatë në forcimin e sistemit demokratik;
- Pasurimi i vazhdueshëm arkivor për motive edukimi qytetar dhe studimi social dhe historic dhe rritjes së aksesit në dokumentat e ish-sigurimit të shtetit në kuadër të transparencës, informimit publik dhe drejtësisë sociale;
- Progresi në procesin të kërkimit, gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur gjatë periudhës së diktaturës nëpërmjet intensifikimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe lidhjes së marrëveshjeve/protokolleve të bashkëpunimit.

I. 2. PLANI STRATEGJIK 2023 – 2028

I.2.1. Objektivi i dokumentit

Objektivi i dokumentit “Plani Strategjik i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit për vitet 2023-2028” është të përcaktojë më nënryre të përgjithshme skemën normative në të cilën mbështetet veprimtaria e Autoritetit, duke formuluar Qëllime Strategjike dhe Objektiva të qarta për të, për 5 vitet e ardhshme, me qëllim që të konsolidohet zbatimi i ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar.

I.2.2 Metodologjia

“Plani Strategjik i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit për vitet 2023-2028” është hartuar mbi bazën e një analize të detajuar që ka pasur për qëllim të vlerësojë zbatimin e Planit Strategjik të Autoritetit për periudhën 2017-2022. Ky vlerësim ka marrë për bazë sukseset e arritura, sfidat dhe zhvillimet e pritshme për periudhën e ardhshme për Autoritetin. Praktikën më të mirë të institucioneve të pavaruara dhe kushtetuese dhe të ngritura me ligj brenda vendit, si dhe ato ndërkombëtare në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike janë marrë për bazë gjatë hartimit të këtij Plani Strategjik.

Procesi i hartimit të Planit Strategjik është realizuar nga administrata e Autoritetit nën drejtimin e Kryetares së Autoritetit dhe gjatë gjithë procesit të hartimit të saj janë përfshirë punonjësit dhe drejtuesit e njësive organizative brenda strukturës së Autoritetit. Kontribut të vleshëm në hartimin e kësaj Strategjie kanë dhënë edhe anëtarët e Autoritetit të zgjedhur nga Kuvendi.

Procesi i hartimit të Planit Strategjik ka kaluar përmes këtyre fazave:

- Faza përgatitore dhe planifikimi i hartimit të Strategjisë.
- Mbledhja e të dhënave, informacioneve dhe analiza fillestare e situatës.
- Diskutime në tryeza të posaçme pune me Autoritetin për hartimin e objektivave dhe veprimtarive.
- Hartimi i Strategjisë dhe i Planit të Veprimit.
- Vlerësimi i kostos së zbatimit.

Faza përgatitore dhe planifikimi i hartimit të Strategjisë – Grupi i punës ngritur me Urdhër të Kryetares së bashku me ekspertin e angazhuar për këtë qëllim kanë zhvillur disa takime pune në ambientet e Autoritetit, ku u diskutuan qasja dhe planifikimi i rubrikave dhe seksioneve që duhet të përmbajë Plani i ri Strategjik, së bashku me disa konsiderata të përgjithshme për përmbajtjen dhe formulimin e tyre.

Mbledhja e të dhënave, informacioneve dhe analiza e situatës – Analiza e situatës ka një rëndësi të veçantë në përgatitjen e një dokumenti strategjik, analizë nga e cila varet edhe vetë suksesi i zbatimit. Duke marrë këtë fakt në konsideratë, gjatë kësaj faze punonjësit, drejtuesit e njësive brenda Autoritetit dhe ekspertët punuan për identifikimin e arritjeve dhe të sukseseve të Autoritetit, si dhe të sfidave dhe problemeve që duheshin trajtuar për të ardhmen. Analiza e situatës u bazua në dokumente të vëna në dispozicion nga Autoriteti.

Hartimi i Planit të ri Strategjik – Gjatë kësaj faze, është përgatitur drafti i Strategjisë, i cili ka marrë për bazë gjetjet nga Raporti i zbatimit të strategjisë paraprake, SWOT analiza, diskutimet e zhvilluara me stafin e Autoritetit dhe anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi. Secili nga grupet e themeluara sipas objektivave, pas takimeve të mbajtura, kanë dhënë kontributin e tyre në finalizimin e objektivave specifike.

Metodologjia e zbatuar synoi të eliminojë përsëritje apo paqartësi të cilat ishin evidentuar gjatë zbatimit të Planit Strategjik 2017-2022. Grupi i punës mbajti në konsideratë nevojën për të formuluar objektiva sa më të qarta, të prekshme dhe të përmbledhura në funksion të përcaktimit sa më efektiv të funksioneve të Autoritetit dhe detyrave ligjore të rëndësishme të ngarkuar për t'u realizuar.

1.2.3. Kuadri intitucional

Autoriteti është person juridik publik, i pavarur, përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 45, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

AIDSSH-ja është një organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi. Kryetari i Autoritetit zgjidhet me vendim të Kuvendit nga radhët e anëtarëve të tij. Autoriteti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ndihmohet nga sekretariati teknik.

Funksionet e Autoritetit lidhen me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to. AIDSSH-ja e ka selinë në Tiranë dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme. Ai ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për ushtrimin e funksioneve të veta. Me ndryshimet në vitin 2020 në ligjin e tij bazë “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH-së”, Autoriteti -ja ka marrë një rol të ri, koordinues, me të gjitha institucionet e tjera shtetërore për procesin e gjetjes, identifikimit dhe rekuperimit të trupave të të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit.

Ky Autoritet ka disa përgjegjësi të rëndësishme, të cilat lidhen ngushtësisht me garantimin e të drejtës për informim dhe mbledhje provash për familjarët e viktimave të zhdukjes me forcë. Këto përgjegjësi përfshijnë:

- ❖ Grumbullimi i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për qëllimet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji;
- ❖ vlerësimi, renditja, evidentimi, ruajtja dhe administrimi i dokumenteve, sipas rregullave dhe parimeve të legjislacionit në fuqi për arkivat;
- ❖ bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës me autoritetet publike dhe arkivat për qëllime të zbatimit të ligjit;
- ❖ dhënia e informacioneve e të njoftimeve mbi dokumentet, si dhe garantimi i shqyrtimit dhe dorëzimin e tyre për kërkuesit;
- ❖ mbështetje kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e publikatave të dokumenteve;
- ❖ informimi i individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Autoriteti raporton për veprimtarinë e tij përpara Kuvendit, një herë në vit, si dhe sa herë i kërkohet nga Kuvendi.

Kryetari i Autoritetit këto kompetenca ligjore ndër të cilat më të rëndësishme janë: vendos për rendin e ditës, thërret dhe drejton mbledhjet e Autoritetit; kujdeset për zbardhjen, publikimin, si dhe zbatimin e vendimeve të Autoritetit; përfaqëson Autoritetin në marrëdhënie me të tretët; d) drejton administratën e Autoritetit; siguron bashkëpunimin institucional të Autoritetit me institucionet vendase dhe të huaja, si dhe në projekte, nisma rajonale, ndërkombëtare, në përputhje me qëllimin e veprimtarisë së Autoritetit dhe propozon kërkesat e Autoritetit për nevoja buxhetore dhe personel apo ndryshime legjislative në organet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

1.2.4. Kuadri Ligjor

Ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” përcakton rregullat dhe procedurat për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Këto të fundit përfshijnë dokumentet për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 Korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së

Shqipërisë dhe që lidhen me veprat penale politike, pavarësisht nëse është dhënë ose jo një dënim për këto vepra nga organet kompetente të regjimit komunist.

Rregullat dhe procedurat që përcakton ky ligj lidhen me:

- mbledhjen, administrimin, përpunimin dhe përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;
- organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- njohjen e personave me të dhënat e ruajtura nga ish-Sigurimi i Shtetit për ta;
- vënien në dispozicion të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore të informacioneve të domosdoshme për qëllimet e ligjit, si dhe,
- përcakton detyrimet e autoriteteve publike dhe arkivave për të vënë në dispozicion dokumentet e disponuara prej tyre.

Ligji i kushton një rëndësi të veçantë rregullimit të funksionimit dhe organizimit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit. Sipas këtij ligji, çdo person ka të drejtë të kërkojë nga AIDSSH-ja që të informohet nëse në dokumentet e administruara ka informacione për personin e tij, si dhe t'i marrë këto informacione, kur ka të tilla. Në varësi të kompleksitetit dhe shkallës së vështirësisë së evidentimit të dokumentacionit, për çdo rast, Autoriteti përgjigjet brenda një afati të arsyeshëm. Rregulla të hollësishme mbi këto afate parashikohen në rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Autoritetit.

Garantimi i së drejtës për informim është një nga parimet bazë për zbatimin e këtij ligji. Ai parashikohet në Nenin 20 të ligjit dhe lidhet me të drejtën e kërkuesit për t'u njohur me dokumentet kur ai ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit të ish-Sigurimit të Shtetit ose është një përfaqësues me prokurë i këtyre të fundit. Kjo e drejtë përfshin njohjen dhe shqyrtimin e dokumenteve origjinale ose publikatave të tyre. Megjithatë, Autoriteti mund ta kufizojë pjesërisht ose plotësisht garantimin e së drejtës për informim, kur të dhënat përbëjnë kërcënim real për sigurinë kombëtare.

Në rastet kur dokumentet ose publikatat, përveç informacioneve personale mbi kërkuesin, përmbajnë edhe të dhëna për të prekur të tjerë apo palë të treta, shqyrtimi i dokumenteve origjinale garantohet vetëm kur kjo miratohet nga të prekurit e tjerë apo palët e treta; është e pamundur ndarja e të dhënave mbi të prekurit e tjerë apo palët e treta; ose është e mundur vetëm me përpjekje të pajustificuara dhe nuk ka arsye për të prezumuar se të prekurit e tjerë apo palët e treta kanë interes të ligjshëm për mbajtjen e këtyre informacioneve të fshehta.

Ligji trajton në mënyrë specifike të drejtat për informim të familjarëve të të vdekurve apo të zhdukurve në Nenet 22 dhe 22/1 të tij. E drejta për të kërkuar informacion mbi ekzistencën e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për personat e vdekur dhe të shpallur të zhdukur, si dhe për shqyrtimin e dokumenteve u njihet edhe të afërmeve të tyre, sipas kësaj radhe përparësie:

a. Bashkëshortëve;

b. Fëmijëve;

c. Fëmijëve të fëmijëve, kur personat e parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;

ç. Prindërve, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;

d. Vëllezërve dhe motrave, kur personat e parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur;

dh. Fëmijëve të vëllezërve dhe motrave, kur personat e radhëve të mësipërme kanë vdekur ose janë shpallur të zhdukur.

Të afërmve u vihet në dispozicion informacioni me kërkesë dhe duke treguar lidhjen familjare. Synimi është ruajtja e të drejtave të personalitetit të të vdekurve apo të zhdukurve, në veçanti për sqarimin e akuzës së bashkëpunimit me ish-Sigurimin e Shtetit; si dhe për të qartësuar fatin e të vdekurve apo të të zhdukurve.

Në kuadër të bashkëpunimit për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të të zhdukurve dhe të të ekzekutuarve, si dhe masave për ruajtjen e vendvarrimeve, AIDSSH-ja bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe vendore për procesin e identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht apo që do të identifikohen si vendvarrime. Rregulla më të hollësishme lidhur me këtë bashkëpunim parashikohet të detajohen në marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe ndërmjet institucioneve, ndërsa hollësi të tjera të këtyre parimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

1.2.5. Ndryshimet e bëra në vitin 2022

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr .72/2022, miratoi ndryshime të rëndësishme në ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Ndryshimet më kryesore kanë të bëjnë me:

- Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Autoriteti mund: a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët duke garantuar në çdo rast konfidencialitetin e individëve, që ofrojnë informacion si persona të përfshirë ose në dijeni për rrethanat e çështjes; b) të marrë dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike; dhe c) të vizitojë dhe të kontrollojë sende apo vende të përfshira.

- Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë me Autoritetin kur rezulton se ka dijeni për rrethanat e çështjes, i kërkohet informacion si person i përfshirë ose që ka dijeni për rrethanat e çështjes, apo kur ai vetë disponon informacion që e ndihmon Autoritetin në punën e tij. Autoriteti në zbatim të këtij ligji ka detyrimin të garantojë konfidencialitetin për çdo person që bashkëpunon.

- Çdo person gëzon të drejtën të njihet me dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe të kërkojë një kopje të tyre në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit, me kusht që kërkuesi të paraqesë të dhëna në kërkesën e tij që mundësojnë lokalizimin e informacioneve. Informacioni jepet vetëm kur angazhimi i nevojshëm për gjetjen dhe vënien në dispozicion të informacionit është në përpjestim të drejtë me interesin e argumentuar të kërkuesit në marrjen e këtij informacioni, ndërkohë që kërkuesi mban përgjegjësi për keqpërdorimin e informacionit të marrë.

- Deklasifikohen të gjitha dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të parashikuara në këtë ligj për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë. Autoriteti përgjegjës për grumbullimin dhe administrimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, kur gjatë punës ndeshet me dokumente që përmbajnë informacione që lidhen me cenimin e sigurisë kombëtare, i klasifikon ato sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.”.

- Shfuqizimin e përcaktimit ligjor sipas të cilit Autoriteti nuk administron kërkesat për informacion për zyrtarët që propozohen të emërohen ose ngrihen në detyrë në institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, kur Autoriteti administron apo i janë vënë në dispozicion dokumenti autentik origjinal i çertifikatës së pastërtisë së figurës, shoqëruar me vendimin përkatës nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit n+r. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar.

1.2.6. Struktura e Autoritetit

Referuar Vendimit të Kuvendit 19/2023 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit Nr. 95/2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të AIDSSH”, I ndryshuar, struktura e Autoritetit është e organizuar në 1 drejtori të përgjithshme- Drejtoria e Përgjithshme e Trajtimit të Kërkesave, e cila ka në varësi katër Drejtori: Drejtoria e Informacionit, Drejtoria e Verifikimit të Figurave, Drejtoria e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në procesin e Identifikimit dhe Rikuperimit të Personave të Zhdukur dhe Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar. Paralelisht me katër drejtoritë që janë në ombrellën e DP. të Trajtimit të Kërkesave, funksionojnë edhe 2 drejtori të tjera: Dr. e Arkivit, Dr. Shërbimeve të Brendshme dhe Financës dhe Drejtoria e Teknologjisë, Informacionit, Digitalizimit dhe Sigurisë.

DPTK si dhe DA, DSHBF dhe DTIDS janë në varësi të drejtpërdrejtë të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili është nëpunësi civil më i lartë i institucionit.

Numri total i stafit sipas organogramës së re është 73. Aktualisht, 20% e pozicioneve të strukturës janë vakante. Vendet e lira shpjegohen me disa faktorë:

- Mobilitetin e stafit për gjetje mundësish punësimi më të mira në funksion të rritjes në karrierë dhe shpërblimit financiar;
- 8 pozicione janë aprovuar shtesë për vitin 2023 me vendimin 19/2023, i cili është depozituar pranë Arkivë-protokollit të Autoritetit në 28 Mars 2023;
- Kufizimet e ligjit për pezullim të procedurave të rekrutimit 30 ditë para zgjedhjeve për pushtetin vendor të datës 14 Maj 2023.

Me ndryshimin e strukturës, fillimisht institucioni i është nënshtruar një procesi ri-strukturimi, për të bërë një ri-shpërndarje sa më efektive të BNJ ekzistuese referuar organogramës së re dhe paralelisht u hartua dhe plani i rekrutimeve për vitin 2023, i cili është në proces.

Një nga sfidat por edhe rreziqet që mund të afektojnë implementimin e këtij plani strategjik është adresimi i problemit të lëvizshmërisë së lartë të stafit. Me reformën në sistemin e pagave në admin-


istratën publike, besojmë që kjo problematikë do të zbutet në një masë të konsiderueshme, pasi punësimi në administratë pritet të bëhet më atraktiv. Përvec kësaj, qasja për ngritje në detyrë për stafin ekzistues do të ndihmojë në rritjen e shkallës së motivimit dhe në reduktimin e këtij fenomeni.

Bazuar në Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Autoritetit, është krijuar një kuadër rregullator për funksionimin me efikasitet dhe eficiencë të administratës, ku secila prej këtyre strukturave e ka të mirëpërcaktuar misionin dhe detyrat që duhet të realizojë.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj administrata e Autoritetit bazohet në këto parime:

- parimi i barazisë
- parimi i ligjshmërisë
- parimi i ndalimit të konfliktit të interesit
- parimi i mbrojtjes së interesit publik
- parimi i vazhdimësisë
- parimi i transparencës
- parimi i ndershmërisë
- parimi i bashkëpunimit

Më poshtë, organigrama e Autoritetit.



KREU II - PLANIFIKIMI STRATEGJIK 2023-2028

II.1 Vështrim i përgjithshëm mbi Planin Strategjik

Plani Strategjik 2023 – 2028, merr në konsideratë të gjithë kontekstin normativ dhe shoqëror të çështjes së të drejtës së informimit për dokumentat e ish-sigurimit të shtetit në shoqërinë shqiptare. Ai mbështetet në arritjet e deritanishme të Autoritetit, dhe pasi merr në konsideratë burimet, strukturat dhe sistemet në dispozicion, parashtron planin e veprimit të tij në pesë vitet e ardhshme duke iu përgjigjur vizionit dhe misionit si refleksione të kompetencave ligjore të Autoritetit.

Qëllimet strategjike transmetojnë vizionin dhe misionin e Autoritetit në objektiva specifike dhe këto më pas zërthehen në masa për zbatimin e strategjisë. Plani Strategjik 2023 – 2028 mbështetet në ekspertizën e akumuluar në kapitalin njerëzor të administratës së Autoritetit, për të projektuar më tej, me ndihmën e teknologjive inovative dhe kompetencave të dalluara menaxheriale, konsolidimin e mëtejshëm institucional.

Në këtë vështrim, Plani Strategjik 2023 – 2028 do të mbështetet në qëllimet e mëposhtme strategjike:

- 1. Rritja e performancës financiare, nëpërmjet një planifikimi sa më realist, vizionar dhe të mirë-argumentuar të buxhetit sipas zërave dhe implementimit me efektivitet dhe efikasitet të tij;**

Referuar realizimit buxhetor të pesë viteve të mëparshme 2018-2019-2020-2021-2022, situata paraqitet si më poshtë:

vitet	plani i buxhetit	realizimi faktik	realizimi ne %
2018	57,088,542	54,543,154	96
2019	61,058,000	47,814,505	78
2020	78,000,000	63,361,059	81
2021	103,476,000	89,580,195	87
2022	102,357,800	88,963,693	87

DSHBF dhe Sektori i Financës dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik do të jenë përgjegjës për të garantuar reflektimin e objektivave dhe prioriteteve në këtë plan, në parashikimet afatmesme buxhetore; hartimin e nevojave buxhetore vjetore dhe shpërndarjen sa më optimale të tyre; si dhe optizimin në përdorimin e tyre. Duke parë trendin e realizimit vjetor buxhetor në 5 vitet pararendëse, (2018-2022), përveç problematikave që lidhen me kapacitete të kufizuara për menaxhimin në kohë të proceseve prokuruese për mallra, shërbime dhe punë në funksion të veprimtarisë së Autoritetit, del në pah edhe domosdoshmëria e një shpërndarje më të mirë të parasë në zëra ku kemi më shumë nevojë dhe kapacitete shpenzuese.

2. Rritja e burimeve financiare nëpërmjet sigurimit të financimeve donatore për komponentë të caktuar të veprimtarisë së Autoritetit;

Ashtu si në të shkuarën, Autoriteti nuk do të mjaftohet vetëm me fondet buxhetore, por do të orientohej edhe drejt përpjekjeve konkrete për projekte me financim donator për komponentë të caktuar të veprimtarisë së tij. Theksojmë që gjatë funksionimit të tij, Autoriteti ka krijuar një rrjet (netëork) komunikimi dhe bashkëpunimi shumë i favorshëm për të ideuar projekte dy ose shumëpalëshë. Një nga prioritetet e punës së Autoritetit do të jetë jetësimi i rezultateve konkrete në gjetjen dhe identifikimin e personave të zhdukur gjatë periudhës 1944-1991.

3. Rritje e efencës dhe efektivitetit institucional nëpërmjet hartimit të Manualit të Procedurave të Brendshme të Punës për të gjitha funksionalitetet e Autoritetit;

Brenda vitit 2023, cdo strukturë e Autoritetit do të identifikojë nevojat konkrete për ngritje të procedurave standarte të punës dhe sëbashku me DSHBF, e cila do të koordinojë të gjithë procesin, do të hartohet një kalendar pune me etapat dhe afatet kohore deri në mbyllje të tij.

DSHBF do të jetë përgjegjëse për të përcaktuar metodologjinë e ngritjes së PSV-ve, ndërsa secila strukturë do të hartojë draftet përkatëse, të cilat do të verifikuan për nga respektimi i metodologjisë dhe pajtueshmëria me bazën ligjore nga DSHBF-Sektori Juridik.

Hartimi i Manualit të Procedurave Standarte të punës do të ndikojë në efencën e cdo strukture të Autoritetit, pasi do të kemi një standartizim të cdo procesi pune, me ëork-floë të qartë, personat përgjegjës dhe afatet kohore për cdo etapë.

Mbi të gjitha, këto procedura do të rregullojnë procese pune ku janë të përfshira dy ose më shumë struktura dhe koordinimi apo ndarja e roleve është jo e qartë ose e diskutueshme.

Procesi si i tërë do të përfundojë brenda vitit 2024.

4. Forcimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit me organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare dhe mediat;

Bashkëpunimi me një spektër sa më të gjerë të stakeholders në veprimtarinë e Autoritetit, ka qenë dhe mbetet një objektiv nga më prioritarët të institucionit tonë. Ky bashkëpunim do të vijojë edhe në të ardhmen duke e zgjeruar rrjetin e bashkëpunëtorëve, nëpërmjet vizitave studimore, aktiviteteve të përbashkëta dhe Marrëveshjeve të Bashkëpunimit/Mirëkuptimit. Pa kontributin e tyre, ne nuk mund të rritemi profesionalisht si institucion, por edhe nuk mund të arrijmë në çdo qelizë të shoqërisë sonë me informim, edukim, ndërjegjësim. Të gjithë duhet të jenë të interesuar për të njohur të vërtetën e së shkuarës, por disa grupime të caktuara identifikohen si më kryesoret, sepse janë ato që mbartin peshën më të madhe në përhapjen dhe tejçimin e informacionit:

- **Të rinjtë** - Të rinjtë janë audiencia kyçe më afatgjatë. Me mediumet e tyre të reja dhe të jetuarit e shpejtë, janë ata që mund ta kthejnë brenda natës një temë të panjohur në një debat kombëtar. Por si të arrish një audiencë që nuk ka interes? Që mendon dhe jeton ndryshe? Që është rritur me internet dhe me kontent të konsumueshëm lehtë? Kjo është pikërisht sfida më e madhe dhe detyra më e rëndësishme. Nëse nuk arrijmë të lidhim këto dy hallka, e shkuara do të harrohet dhe historia nuk do të na falë. Ndaj me në mendje të rinjtë, duhet të synohet aktivisht me çdo mjet koherent, kjo audience dhe të përfshihet në çdo aktivitet, event apo iniciativë.

- **Individët dhe familjet e prekura** - Janë dëshmitarët dhe treguesit e gjallë të gjithçkaje që të tjerët mund të lexojnë vetëm në letër. Dëshmitë e tyre kanë fuqinë e vërtetë për të prekur dhe për të afruar të gjitha grup-audienca të tjera. Përfshirja, thellimi, dëgjimi, mbledhja dhe afrimi i këtij target grupi në të gjitha aktivizimet plotëson kuadrin e komunikimit dhe qarkun e kujtesës.
- **Studiuesit dhe gazetarët** - Me barrën e madhe të studimit, thellimit, njohjes dhe ndarjes së informacionit, studiuesit dhe gazetarët duhet të jenë një grup aktiv i përfshirë vazhdimisht në iniciativë të organizuara nga vetë Autoriteti, por edhe nismave të tjera të ndërmarra nga media, institucione apo edhe individë. Ky grup duhet të përfshihet, por edhe të stimulohet për të luajtur rolin kyç të lidhjes mes institucionit dhe komunikimit masiv.
- **Institucionet** - Përfaqësues nga institucione që lidhen dhe mbulojnë fushat e arsimit, kulturës, turizmit dhe zhvillimit lokal, që janë të përfshirë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në aktivizime dhe bashkëpunime me Autoritetin.
- **Shoqëria civile** - Përfaqësues të organizatave të lidhura me të drejtat e njeriut, apo me të shkuarën historike, që janë aktivë dhe që mund të përfshihen në projekte e aktivizime.
- **Audienca e gjerë** - Komuniteti lokal deri tek audienca ndërkombëtare, këtu përfshihen të gjithë ata, që në një kohë të caktuar kanë interes të mësojnë më shumë rreth së shkuarës.

5. Shtimi i aksesit në informacion si pasojë e pasurimit të vazhdueshëm të Arkivit të Autoritetit

Në harkun kohor 2023-2028 parashikohet të përfundojë procesi i deklasifikimit të fondeve arkivore që disponon arkivi i Autoritetit duke përfshirë edhe aktet ligjorë që e finalizojnë këtë proces, të cilat janë:

- relacionet me propozimet mbi dokumenteve për deklasifikim,
- vendimet për dokumentet e deklasifikuara,
- bibliografitë dhe publikimet në faqen e Autoritetit, Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

II.2 Objektivat strategjike, Objektivat specifike dhe Treguesit për zbatimin e Strategjisë

Objektivat strategjike

- Krijimi i Arkivit të Kartotekës me tipologji si kartela, regjistra, procesverbale apo evidenca të ndryshme të ish Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet pasurimit të vazhdueshëm të dokumentacionit mbi veprimtarinë e ish-sigurimit të shtetit;
- Informacion për të gjithë, në kuadër të informimit apo të studimit, nëpërmjet krijimit të lehtësirave procedurale, digjitalizimit dhe zgjerimit të spektrit në informacionin e aksesueshëm;

- Edukim dhe ndërgjegjësim shoqëror nëpërmjet një platforme komunikimi në spektër 360 gradë dhe një narrative të përmbledhur dhe më të prekshme për të ftuar dhe afuar të gjithë brezat në një dialog më të gjerë mbi të shkuarën;
- Promovimi i Transparencës dhe Drejtësisë Tranzicionale, duke hedhur dritë mbi krimet e kaluara, duke mbështetur procesin e kërkimit, gjetjes, identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të viktimave të ish-Sigurimit; lehtësimin e pajtimit, rehabilitimit dhe drejtësisë tranzicionale.

Objektivi strategjik 1. Krijimi i arkivit të Kartotekës me të gjitha dokumentet me tipologji si kartela, regjistra, procesverbale dhe evidenca të lidhura me veprimtarinë e ish-sigurimit të shtetit gjatë viteve 1944-1991.

Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë përcaktojnë rregullat bazë për organizimin, funksionimin dhe punën në arkivat në veprim të subjekteve shtetërore dhe joshtetërore, në arkivat tekniko-shkencore dhe në arkivat në figurë e në zë.

Përpunimi i të dhënave është një proces i cili lehtëson procesin e evidentimit për më shumë të dhëna, për qasjen dhe shërbimin e dokumenteve arkivore. Arkivistët ruajnë autenticitetin (vërtetësinë) e dokumenteve gjatë përpunimit, ruajtjes dhe shfrytëzimit. Mbi të gjitha, arkivistët zbatojnë disa parime unike të arkivistikës

Për dokumentet të cilat janë të papërpunuara, apo për dokumente të cilat kërkojnë ndarjen tematike sic janë dosjet O.R.V.(objekti i rëndësisë së veçantë), dosje të problemit të centralizuar, seleksionimi i urdhërave apo vendimeve etj, organizohet puna për përpunimin tekniko-shkencor. Paralelisht me përpunimin e fondeve arkivore krijohen edhe mjetet e reja të kërkimit.(kërkimin tematik, kërkimin në bazë pseudonimi, kërkimin individual etj.).

Gjatë digjitalizimit të dosjeve, në metadatën e përcaktuar bëhet përshkrimi i dosjes me 5-6 fjali, për të dhën kontekstin që përmban dosja, dokumentet e hartuara në dosje, vitin që janë krijuar etj.

Objektivi specifik 1.1 – Pasurim dhe qasje e vazhdueshme e dokumentacionit mbi veprimtarinë e ish-sigurimit të shtetit. Koleksione të përbëra nga këto materiale arkivore duke dëshmuar ngjarje dhe histori nga e kaluara.

Veprimet/aktivitetet		Treguesit
1.	Identifikimi i kartelave, regjistrave dhe procesverbaleve në 4 sallat e vendruajtjes së arkivit të Autoritetit dhe grumbullimi në vendruajtjen e përcaktuar për kartotekën. Vlerësim i gjendjes së dokumenteve.	Urdhra/Autorizime/grupe pune për zbatimin e tyre dhe për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim Raport/procesverbal mbi gjendjen aktuale të dokumenteve si dhe niveli i klasifikimit.
2.	Transferimi i dokumenteve në sallën e përcaktuar të arkivit të Autoritetit.	Inventari i plotë i të dhënave në trajtë fizike dhe elektroinike
3.	Hartimi i një plani për organizimin dhe katalogimin e të dhënave për aksesueshmërinë e dokumentacionit me tipologji si kartela, regjistra/evidence si dhe mjetet e reja të kërkimit	Zbatimi i planit të hartuar
4.	Zhvillimi i një plani për deklasifikim të materialeve të cilat janë evidentuar me nivel të klasifikimit si dhe përcjellja për procesin e digjitalizimit	Zbatimi i planit të hartuar.

Objektivi specifik 1.2 – Aksesueshmëria tek të dhënat e disponueshme, për publikun sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë dhënien e informacionit në formë digjitale.

Veprimi		Treguesi
1.	Organizimi dhe katalogimi i dokumenteve materiale sipas standardeve ndërkombëtare të arkivave dhe bibliotekave.	Inventari i dosjeve të organizuara me katalog të kompletuar.
2.	Zhvillimi i një plani dixhitalizimi dhe dixhitalizimi i dokumenteve sipas aksesit, prioritetit të ruajtjes dhe burimeve në vend.	Dokumentet e dixhitalizuara të disponueshme në терминаlet kompjuterike.
3.	Skanimi dhe digjitalizimi i gjithë fondit arkivor.	Digjitalizimi i përfunduar. Venia ne dispozicion nëpërmjet SAD (softweri i Arkives Digjitale).
4.	Krijimi i nje platforme digjitale te aksesueshme per mesuesit, studiuesit, nxenesit dhe studentet e bazuar ne formatin e platformes : Hi-Story Lessons.	Platforma digjitale e ndërtuar.
5.	Krijimi i një mediateke dhe hapësirave më të lehta për diseminimin e informacionit për rritjen e kapaciteteve teknologjike dhe përmirësimi i aksesit online. Dokumentimi nëpërmjet videove/fotografive i eventeve dhe te gjitha aktiviteteve të ndërmarra nga AIDSSH dhe krijimi i një arkive pamore që do të shërbejë për studime, dukumentime dhe publikime.	Mediateka; Numri i studiuesve dhe institucioneve që raportojnë për njohjen e Autoritetit.
7.	Krijimi i Fototekës Digjitale me foto nga arkivi i dosjeve te ish-Sigurimit të Shtetit. Fototeka do të shërbejë për digjitalizimin, mbledhjen dhe ruajtjen e materialeve fotografike që ndodhen në dosje të ndryshme, të cilat janë në proces digjitalizimi. Të gjitha materialet fotografike që ndodhen në dosje do të digjitalizohen në format elektronik me cilësi të lartë dhe do të kenë emërtime sipas referencës arkivore. Ky arkiv i bazuar në fotot dhe imazhet që ndodhen në dosje do të shërbejë për studiues dhe në mbështetje të projekteve të ndryshme edukative dhe sensibilizuese për publikun, etj. Filmimi me dron i vendeve të kujtesës dhe vendeve të dyshuara të ekzekutimeve në diktaturë. Digjitalizimi i kopjeve filmike të vjetra marrë nga arkiva të ndryshme.	Fototeka Digjitale e ndërtuar; Plan veprimi; Materialet përmbajtësore;
8.	Identifikimi i një grupi të vogël të fokusuar tek manualet dhe tek ndërfaqja e përdoruesit të testimit beta.	Ndërfaqja e rishikuar e përdoruesit dhe manualet.

9.	Zhvillimi i politikës së referencës dhe politikave te aksesit për publikun bazuar në Ligjin 45/2015 i ndryshuar, i cili përcakton se kush mund të marrë dosjet dhe si ta bëjë këtë.	Dokument i plotësuar i politikave.
10.	Rishikimi i të gjithë nën-akteve ligjore që kanë si burim Ligjin 45/2015 i ndryshuar.	Udhëzuesët dhe Rregulloret e përfunduara.
11.	Zhvillimi i materialeve hyrëse për prezantim për të gjithë përdoruesit që shpjegojnë rregulloren e aksesit, rregullat, kontekstin dhe ndjeshmëritë e aksesimit te dokumenteve, duke përfshirë faqet e nënshkrimit që kërkohen për pastrimin e përdorimit.	Seti i kompletuar i shkresave për të ndarë me secilin përdorues i cili sheh dosjet.
12.	Trajnimi i stafit me rregullat dhe politikat.	Regjistrimet e seancave të trajnimit të përfunduar; Vlerësimi i seancave të trajnimit.
13.	Nisja e një fushate ndërgjegjësimiti në lidhje me të vërtetën dhe transparencën, si dhe shërbimet e ofruara nga Autoriteti. Organizimi i një konference shtypi rreth nisjes së procesit duke përfshirë përgatitjen e njoftimeve për shtyp dhe ndarjen me të gjitha mediat në Shqipëri.	Regjistrimet e reklamave.
14.	Përditësimi dhe konsolidimi i anëtarësisë dhe i punës së Bordit Këshillues të Autoritetit, që kanë përbërje individë të specializuar në profesionet e tyre.	Përditësimi i Bordit Këshillues

Objekivi strategjik 2. Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar.

Qëllimi i Autoritetit është të rrisë ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në promovimin e vlerave evropiane, përmes njohjes së historisë që kemi jetuar si shoqëri. Për këtë, mendojmë se duhet filluar puna me përgatitjen e mësuesve, për t'u ofruar atyre metodologjinë e qasjes ndaj argumentit dhe mjetet e nevojshme didaktike për ta realizuar si duhet procesin në klasë.

Autoriteti do të mbështesë të drejtën e institucioneve akademike, studiuësve dhe përfaqësuesve të medias për të konsultuar të dhënat e krijuara nga Ish-Sigurimi i Shtetit, me qëllim promovimin e hulumtimeve rigorozë dhe objektive mbi të kaluarën e Shqipërisë dhe për të siguruar edukimin qytetar dhe publik në përgjithësi. Kjo qasje do të jepet në kushte që sigurojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe privatësinë e individëve të përmendur në dosje.

Autoriteti do të mbështesë punën kërkimore që ndihmon në rivlerësimin e aktivitetit të Ish-Sigurimit dhe vlerësimin e ndikimit të aktivitetit të tij në historinë e Shqipërisë nën komunizëm. Përveç kësaj, Autoriteti do të angazhohet në edukimin publik, duke iu drejtuar publikut përmes aktiviteteve të tilla si Dita e Përkujtimit të Viktimave të Ish-Sigurimit të Shtetit, Dita Evropiane e Përkujtimit të Viktimave të Sistemeve Totalitare, përmes partneriteteve me shkollat dhe Ministrinë e Arsimit dhe përmes platformave sociale dhe tradicionale të medias.

Një hulumtim aktiv dhe axhendë e edukimit publik, mund të ndihmojë në pozicionimin e Autoritetit brenda peizazhit më të gjerë akademik vendas dhe ndërkombëtar. Autoriteti do të marrë parasysh përcaktimin e fushave me interes të veçantë kërkimor dhe nënshkrimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit për bashkëpunim me kërkuesit, universitetet dhe organizatat që punojnë në këto fusha. Gjithashtu, Autoriteti do të organizojë konferenca, kurse arsimore trajnime, vizita mësimore dhe botime për komunizmin shqiptar, si dhe të lidhet me rrjetet më të gjera kërkimore që përqendrohen në të drejtat e njeriut, trashëgiminë e komunizmit dhe totalitarizmin ndërkombëtar.

Këto përpjekje, do të jetë vendimtare për të siguruar reputacionin e Autoritetit dhe bashkëpunëtorëve të tij për analizë komplekse të ngjarjeve dhe trashëgimive historike.

Objekti i Specifik 2.1 - Themelimi i Autoritetit si një burim arkivor qendror për kërkime mbi aktivitetet e Sigurimit.

Veprimi		Treguesi
1.	Përcaktimi i fushave kërkimore që Autoriteti dëshiron të mbështesë.	Përshkrimi i listës së fushave kërkimore.
2.	Krijimi i bashkëpunimit me universitete, arkiva dhe qendra kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, që punojnë në këto fusha kërkimore.	Memorandume të Mirëkuptimit ose Letra të Bashkëpunimit.
3.	Ngritja e një politike qasjeje për studiuesit, duke përfshirë rregullat për qasje dhe përdorimin e dokumenteve (plani duhet të adresojë llojin e projekteve të përkrahura, kërkesat për qasje, rregullat mbi privatësinë dhe citimin, dhe rregullat për përdorimin fizik të dorëshkrimeve).	Politika e plotësuar me dokumentet përkatëse për përdorim.
4.	Krijimi i një dhome/salle leximi ku dokumentet mund të përdoren nën mbikëqyrje.	Dhoma e krijuar e leximit e furnizuar me terminale kompjuterike, tavolina dhe pajisje të tjera.
5.	Ndërtimi i një biblioteke në terren me materiale plotësuese, si fizike ashtu edhe në internet, të rëndësishme për studimin e Sigurimit, komunizmit në Shqipëri dhe sundimit totalitar në përgjithësi.	Krijimi i bibliotekës.
6.	Zhvillimi i materialeve reklamuese dhe katalogut online në pronësi të Autoritetit. Vendosi e dokumenteve online të përzgjedhura dhe përcaktimi i niveleve të duhura të qasjes së jashtme.	Materialet e kompletuara (broshura, etj.) dhe katalogjet e bibliotekës. Ngarkohen skedarët e zgjedhur dhe protokollet e qasjes.

7.	Reklamimi i gjetjeve në universitete dhe qendra kërkimore brenda dhe jashtë vendit.	Numri i studiuesve dhe institucioneve që raportojnë për njohjen e Autoritetit.
8.	Krijimi i një komisioni me personalitete vendase për të shkruar një studim të shkurtër të rëndësisë së materialeve arkivore dhe kërkimit në këto arkiva; Përkthimi në gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera relevante.	Studim i përfunduar.
9.	Organizimi i konferencave, simpoziumeve dhe botimeve.	Konferencat e organizuara dhe botimet e bëra.
10.	Bashkëpunim me ambasadat shqiptare dhe konsullatat jashtë vendit për të njohur universitetet e huaja, institutet kërkimore ndërkombëtare, OJF-të, dhe emigrantët shqiptarë.	MoUs me ambasadat shqiptare; Të dhënat e ambasadave ose ngjarjeve konsullore në lidhje me Autoritetin.

Objekti i specifik 2.2 – Prezantimi i Autoritetit si një platformë për angazhimin publik dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri.

Veprimi		Treguesi
1.	Vendosja e ekspozitave në ndërtesën e Autoritetit, të hapura për publikun. Bashkëpunimi me artistë dhe elemente artistike për të tejçuar mesazhe nëpërmjet artit dhe ekspozitave të herëpas-herëshme; Mundësimi i ekspozitave të lëvizshme në shkolla apo universitete në periudha të ndryshme.	Ekspozitat e përfunduara; Plani i përfunduar për lëvizjen e ekspozitave në shkolla e universitete
2.	Zhvillimi i një plani të medias me materiale, duke përfshirë broshurat, mesazhet dhe imazhet; Krijimi i një Klubi të Mediave me gazetarë të specializuar në këto çështje. Krijimi i konkurseve artistike me tematika të caktuara, për ngjarje dhe personalitete që kanë shënuar historinë dhe që i përkasin periudhës 1944-1991.	Plani i plotë i komunikimit me materialet shoqëruese (materialet e printuara, njoftimet për shtyp, postimet elektronike dhe gazetat, bloget etj.); Krijimi i broshurave me materiale informuese për ngjarje të spikatura që kanë ndodhur në periudhën e diktaturës.
3.	Zhvillimi i Strategjisë së Komunikimit për palët e interesuara relevante publike dhe private (agjencitë publike, OJQ-të, universitetet) si dhe audiencat e huaja (duke përdorur ambasadat dhe konsullatat), si dhe i një Plani Komunikimi.	Plani i përfunduar, me listat e materialeve (materialet e printuara, postimet elektronike dhe gazetat, bloget etj.) dhe ngjarjet që synojnë audiencat të ndryshme.

<p>4.</p>	<p>Zhvillimi i Planit Social Mediatik për Autoritetin, përfshirë planet për Aplikacionet, Facebook, Instagram, LinkedIn, Tëitter, dhe Tik Tok.</p> <p>Krijimi i një ‘Pod cast-i’ ndërveprues me ish të dënuar, familjarë të tyre dhe nxënës, student, studiues, psikologë, sociologë, punonjës sociale, apo profesionistë të tjerë.</p>	<p>Plani i përfunduar me materialet shoqëruese sipas zërave.</p>
<p>5.</p>	<p>Kryerja e informimit dhe ndërgjegjësimit edukativ në shkolla, duke përfshirë futjen e çështjeve të transparencës historike.</p> <p>Në funksion të marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit do të nxiten aktivitetet me shkollat, që ditët e kujtesës dhe njohja me krimet e komunizmit të jenë pjesë e projekteve të shkollave në orët ekstrakurrikulare. Krijimin e një cikli emisionesh në shërbim të edukimit qytetar.</p> <p>Krijimi i një aplikacioni që do të përmbajë të dhëna historike dhe informacione për ngjarje të ndryshme të ndodhura gjatë periudhës 1944-1991 dhe disa faqeve të internetit që kanë lidhje me to dhe që do të përditësohen me dëshmi, fakte e dokumente të reja, duke pasuruar platformën për arsimin.</p>	<p>Anketimi në shkolla.</p> <p>MoU me Ministrinë e Arsimit;</p> <p>Plan vizitash në Autoritet dhe në site të kujtesës historike dhe kolektive, përmes bashkëpunimit me MAS dhe Drejtoritë Arsimore në vend;</p>
<p>6.</p>	<p>Zhvillimi i vazhdueshëm i aktiviteteve dhe eventeve lidhur me ditët e kujteses brenda dhe jashtë ambjentëve të institucionit sipas kalendarit dhe eksperiencave të viteve të shkuara.</p>	<p>Kalendari i kujtesës shpërndarja në shkolla për kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta;</p> <p>Databazë e dialogjeve lokale; bashkëpunimi me grupet e interesit;</p>
<p>7.</p>	<p>Ndërtimi i një ekipi të rinjsh të atashuar pranë institucionit, të cilët të mund të kenë mundësi të krijojnë video dhe mini produksione të menduara si kontent për rrjetet sociale, duke përdorur perspektivën e tyre rinore.</p>	<p>MOU me MAS dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me Drejtoritë Arsimore në vend;</p>
<p>8.</p>	<p>Bashkëpunimi me influencues të zhanreve dhe prejardhje të ndryshme, që ndiqen nga audienca të ndryshme për të folur dhe promovuar ndërgjegjësimin për këto tema të ndjeshme dhe shpesh të vështira për t’u kuptuar nga audienca e re.</p>	<p>Shkresat, komunikimet, Marrëveshjet e Bashkëpunimit</p>
<p>9.</p>	<p>Pasurimi i arkivës; Grumbullimi i vazhdueshëm në formë arkive i historive personale njerëzore dhe përfshirja e tyre në publikime, koleksione dhe podkaste të dedikuara apo forma të tjera më të lehta për konsum masiv.</p>	<p>Arkiva digjitale e dëshmi audiovizuale; librat dhe botimet</p>

Objektivi strategjik 3. Promovimi i Transparencës dhe Drejtësisë Tranzicionale.

Shtetet mbajnë një përgjegjësi për të siguruar paqen e qëndrueshme, pajtimin dhe kohezionin shoqëror. Hulumtimi për persona të zhdukur, përcaktimi i rrethanave të zhdukjes së tyre dhe mbrojtja e personave nga zhdukja është një element integral në sigurimin e këtij objekti. 6. Vlerësohet se rreth 6,000 persona u zhdukën nën regjimin komunist në Shqipëri në periudhën midis 1944 dhe 1991. Si pas të dhënave zyrtare rreth 5,501 persona të dënuar për arsye politike, u ekzekutuan gjatë kësaj periudhe. Trupat e tyre nuk u kthyen kurrë në familjet e tyre. Të dhënat zyrtare tregojnë gjithashtu se 987 të burgosur politikë vdiqën nga shkaqe të ndryshme në burgje dhe qendra të paraburgimit në Shqipëri. Vendndodhja e mbetjeve të tyre mortore është e panjohur për të afërmit që mbijetuan.

Në korrik 2020, Parlamenti shqiptar miratoi ndryshimet në Ligjin 45/2015 (Për të Drejtën e Informimit në lidhje me ish-Dokumentet e Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë), duke i dhënë Autoritetit një rol më të spikatur, koordinues në proces. Neni 22/1 përcakton se: "Autoriteti bashkëpunon me institucionet shtetërore qendrore dhe lokale në procesin e identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë epokës komuniste, si dhe për marrjen e masave për të mbrojtur dhe ruajtur, në mënyrën më të mirë e përshtatshme, vendet që aktualisht janë identifikuar ose do të identifikohen si vendet e varrimit. Rregullat e bashkëpunimit midis Autoritetit dhe institucioneve qendrore dhe lokale për identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të të zhdukurve gjatë epokës komuniste do të përcaktohen në marrëveshjet bilaterale ose multilaterale të lidhura për këtë qëllim".

Në mënyrë domethënëse, ndryshimet në Ligjin 45/2015 për herë të parë sigurojnë një përkufizim të një personi të zhdukur në legjislacionin shqiptar. Neni 4 thotë se "një person i zhdukur është një person i arrestuar, burgosur, rrëmbyer ose privuar nga liria e tij/saj në ndonjë formë tjetër nga agjentët e shtetit ose nga persona të tjerë ose grupe personash, të cilët kanë vepruar me autorizimin, mbështetjen ose miratimin e shtetit, i ndjekur nga mohimi i pranimit të heqjes së lirisë ose fshehja e fatit të personit të zhdukur ose vendit ku ai/ajo ndodhet, duke e shpëputur atë nga mbrojtja e ligjit. " Ndërsa personat e zhdukur më parë nga epoka komuniste ishin përcaktuar ligjërisht si "të përndjekur politik", ndryshimet në ligjin 45/2015 demonstrojnë një njohje të rëndësishme të çështjes së personave të zhdukur për arsye të pavullnetshme nga parlamenti shqiptar.

Disa nga synimet kryesore në kuadër të këtij objekti strategjik përfshijnë:

1. Rregullimet të karakterit ligjor:
 - Plotësimi me akte nënligjore i kërkuar nga ligji nr. 45/2015 për çështjen e identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve gjatë rregjimit komunist.
 - Miratimi i legjislacionit i cili përfshin parashikimet për mbrojtjen e të drejtave të familjeve të personave të zhdukur. Ligji duhet të mbështesë të drejta të tjera jomateriale të familjeve, siç është përkujtimi i datave të rëndësishme ose në vendet me rëndësi.
2. Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore në mënyrë që të mund të koordinojë aktivitetet që kanë të bëjnë me hetimet dhe identifikimin e të gjithë personave të zhdukur nga periudha komuniste.
3. Fillimi i veprimtarisë konkrete brenda vitit 2023 për identifikimin dhe rikuperimit të eshtrave të të zhdukurve gjatë rregjimit komunist.
4. Autoriteti duhet të krijojë dhe mirëmbajë një bazë të dhënash të vetme, të harmonizuar dhe gjithëpërfshirëse të personave të zhdukur. Kjo do të lejonte shtetin të siguronte informacion të saktë dhe të besueshëm në lidhje me rastet e personave të zhdukur. Një bazë e të dhënave do të jetë thelbësore në forcimin e kapacitetit të shtetit për të gjetur të zhdukurit dhe për të lejuar familjet të regjistrojnë të afërmit e zhdukur dhe të ushtrorë të drejtat e tyre so-

- cialle dhe ekonomike. Është e rëndësishme që të gjitha institucionet, organizatat joqeveritare dhe individët që posedojnë informacione mbi personat e zhdukur të sigurojnë të dhëna në posedim Autoritetit që do t'i organizojë, menaxhojë dhe verifikojë ato.
5. Autoriteti duhet të sigurojë mbikëqyrjen publike të aktiviteteve të tij, veçanërisht në lidhje me familjet e të zhdukurve, gjë që do të rrisë nivelin e tyre të besimit në veprimet e tij. Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm duhet të sigurojë që ka një numër të mjaftueshëm të prokurorëve për të ofruar një përgjigje zyrtare për varret e fshehta dhe vendet e krimit nga epoka komuniste, në bashkëpunim me institucionet përkatëse ekzistuese.
 6. Autoritetet shqiptare duhet të ndajnë burime të mjaftueshme për IML për ekzaminimin dhe identifikimin e rasteve të personave të zhdukur në përputhje me standardet ndërkombëtare të mjekësisë ligjore dhe për ruajtjen e duhur të eshtrave njerëzore deri në varrosjen e tyre.

Objektiv specifik 3.1 - Mbështetja e punës së dokumentimit të krimeve të komunizmit, përfshirë kontributin në bërjen e drejtësisë.

	Veprimi	Treguesi
1.	Identifikimi i organizatave vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që punojnë në drejtësinë tranzicionale, si dhe organet e pavarura si Avokati i Popullit dhe komitetet e konventave përkatëse në të cilat Shqipëria është palë.	Tabela e përfunduar e organizatave me interesa dhe kontakte tematike të parashtruara; Përfshirja e anëtarëve të stafit përgjegjës për të vendosur kontakte (tabela e përgjegjësisë).
2.	Zhvillimi i materialeve që paraqesin zotimet e Autoritetit në aspektin e të drejtave të njeriut.	Fletëpalosje e kompletuar e dizajnuar për qasje në organizata të të drejtave të njeriut.
3.	Krijimi i partneriteteve me organizatat e të drejtave të njeriut të interesuara për krimet e komunizmit. Bashkëpunimi me shkollat e universitet e ndryshme për krijimi e ekspozitave apo eseve që i përkasin një tematike të tillë.	Marrëveshje bashkëpunimi me organizatat e përshtatshme
4.	Nisja e praktikës për të ftuar një sërë folësish për çështjet që lidhen me Sigurimin dhe komunizmin shqiptar.	Folësit për t'u identifikuar dhe për t'u ftuar të flasin; Çështjet e diskutuara.
5.	Organizimi i një konference mbi Sigurimin e Shtetit, që fton dijetarët vendas dhe ndërkombëtarë, gazetarët dhe organizatat e interesuara për të drejtat e njeriut dhe trashëgiminë komuniste.	Konferencë; program; Ftesat e dërguara.
6.	Zhvillimi i një fushate për informim në media përqendruar në vlerën e drejtësisë tranzicionale.	Plani i medias, reklamat, dëshmi për informim dhe partneritet me mediat përkatëse.

Objektiv specifik 3.2 - Mbështetja e procesit të identifikimit dhe rigjetjes së mbetjeve të viktimave që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit.

Veprimi		Treguesi
1.	Bashkëpunimi me Prezencën e OSBE-së, Ministrinë e Brendshme, OCOMP, Prokurorinë, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Institutin e Policisë Shkencore, Policinë e Shtetit dhe Pushtetin Vendor, për përfundimin e Draft-VKM-së “Për të Zhdukurit”.	Proces-verbale të tryezave dhe problematikave të diskutuara. Dhe natyrisht draft VKM-ja. Urdhërat e Autoritetit për këto hetime, Planet e veprimit. Raportimet periodike para Autoritetit mbi ecurinë e hetimeve.
2.	Kryerje e hetimeve administrative, përmes të cilëve të grumbullohen prova me dokumente nga institucionet shtetërore, me dëshmi nga ish të dënuar, të mbijetuar, nga familjarë të ish të dënuarve që nuk u janë gjetur eshtrat, dëshmi nga ish-punonjës të Burgjeve gjatë komunizmit, me qëllimin e realizimit të një harte të plotë me vendvarrimet e të ekzekutuarve, të vvarëve, apo të vdekurve gjatë vuajtjes së dënimit në burgjet e komunizmit, me Skicën për secilin vendvarrim të gjetur. Bashkëpunimi me pushtetin vendor, në juridiksionin e të cilit është territori ku gjendet vendvarrimi, për kufizimin dhe ruajtjen e tij në mënyrën më të mirë të mundshme.	
3.	Realizimi i Marrëveshjes me Prokurorinë, me ICMP-në, me IML-në, institute dhe organizata të tjera që kanë rol në proces, me asistencë edhe të Prezencës së OSBE-së.	Marrëveshjet, dhe raportet funksionale me detyra të nominuara për çdo palë gjatë procesit.
4.	Krijimi i Regjistrit me persona të zhdukur gjatë komunizmit, apo të atyre që nuk u janë gjetur eshtrat dhe nuk dihet fati, duke konkluduar me dokumente në një shifër të pakontestueshme. Realizimi i informacioneve të plota rreth tyre, dijenia për të afërmit dhe vendodhja e tyre, me synim që regjistri të ketë rakorduar dhe ezauruar personat e gjetur nga familjarët, dhe në çdo rast gjetjeje të mbetjeve njerëzore, identifikimi të mos vonojë për arsye teknike, mosgjetje të mostrave krahasuese të AND-së, etj.	Dokumentet dhe komunikimet me institucione si Drejtoria e Përgjithëshme e Burgjeve, Ministria e Brendshme, Instituti i Mjekësisë ligjore, etj
5.	Sensibilizimi i shoqërisë dhe rritja e bindjes për seriozitetin dhe dinjitetin e procesit të identifikimit dhe Rikuperimit të personave të zhdukur, çka do çojë në rritjen e aplikimeve nga familjarë të të zhdukurve, për qartësimin e fatit të këtyre të fundit.	Emisione, broshura dhe sensibilizime për çdo vendvarrim në gjithë territorin.

6.	Identifikim dhe përkatësi të mbetjeve njerëzore në çdo vendvarrim, me ndihmën e ICMP-së, dhe relativitet tek Prokuroria për rastet, kur mbetjet njerëzore tregojnë vepra penale. Kthim dinjiteti për mbetjet njerëzore duke i hequr nga gropat e komunizmit ku i kishin fshehur për t'i zhdukur, dhe duke i varrosur në vende të zgjedhura e shënuar me memorial. Database me AND-në e tyre, me qëllim që procesi të jetë i zgjidhshëm në çdo rast kur ofrohen mostrat krahasuese.	Marrëveshjet me Pushtetin Vendor, varrezat e krijuara me eshtra të gjetura, të përkatësuar dhe të koduara me të dhënat e ADN-së, memoriale dhe përshkrime.
7.	Krijim i regjistrimit me të afërm të personave të pagjetur dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithëshme të Gjendjes Civile dhe pushtetin vendor.	Dokumentet e përfuara nga komunikimi i vazhdueshëm me Gjendjen Civile.
8.	Në çdo rast identifikimi të personit të pagjetur, përmes mbetjesh mortore, si rezultat i ekzaminimeve shkencore krahasuese me ndihmën e institucioneve të mirënjohura në këtë fushë, me dakortësinë e familjes së të ndjerit, organizim ceremonie varrimi.	Dokumente të identifikimit me ADN, etj.

Objekti strategjik 4. Mbështetja dhe garantimi e të drejtës për informacion në procesin e verifikimit të kandidatëve dhe bashkëpunimi me institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike.

Një nga tre drejtimet kryesore ku do vijojë të fokusohet veprimtaria e Autoritetit, është vlerësimi i cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë në funksione publike, kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, kryetarë bashkë dhe kryetarë këshilli qarku.

Integriteti i zyrtarëve të lartë publikë është element i domosdoshëm për shtetin e të drejtës. Zgjedhja apo emërimi në një funksion publik, përveçse përbën një të drejtë themelore, përbën në të njëjtën kohë një interes të lartë publik për funksionimin e shoqërisë demokratike, mirëqeverisjen dhe ruajtjen e integritetit dhe transparencës në funksionimin e organeve ligjzbatuese të vendit.

Verifikimi i figurës së kandidatëve në organet e vettingut në drejtësi dhe polici krijoi perceptimin publik se zyrtarët dikur të fuqishëm dhe paprekshëm, për shkak të posteve zyrtare dhe detyrës, sot mund të përballen me pasojat e gabimeve apo sjelljeve të tyre. Statistikisht numri i kandidatëve të verifikuar është një rezultat i lartë dhe ndikoi në rritjen e besimit të publikut ndaj pushtetit dhe bashkëpunimit midis institucioneve.

Gjithashtu në shtator 2019, Parlamenti Europian miratoi rezolutën mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane, duke shprehur jo vetëm respekt për secilën viktimë të sistemeve totalitare, por dhe shqetësim për përdorimin e simboleve të regjimeve dhe glorifikimin e tyre. I njëjti shqetësim është ngritur edhe nga Avokati i Popullit lidhur me emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike me data dhe simbole që lidhen me të kaluarën e regjimit komunist, përdorim që duhet shmangur.

Prandaj dekorimi nga organet shtetërore apo dhënia e medaljeve/titujve të nderit për funksionarët e lartë të regjimit ish-komunist, bashkëpunëtorët e tyre, zyrtarët dhe bashkëpunëtorët e ish- Sigurimit të Shtetit dhe të çdo organi tjetër represiv të regjimit komunist, që me veprimtarinë e tyre kanë kontribuar në përndjekjen survejimin dhe burgosjen e një shtrese të gjerë të përndjekurish politikë dhe në shumicën e rasteve duke shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut, është jo vetëm në shkelje të

parimeve dhe angazhimeve europiane për dënimin e komunizmit, zhdukjes së pasojave të tij dhe rehabilitimit të viktimeve, por edhe një provokim i rëndë i ndërgjegjes shoqërore. Autoriteti do vijojë të jetë i angazhuar me qëllim zhvillimin e procedurave të verifikimit mbi figura apo ngjarje të periudhës 1944-1991, nga institucionet vendore përkatëse. Me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish Sigurimit”, garantimi i kësaj të drejte ka njohur përmirësim të vazhdueshëm, duke ndikuar në rritjen e transparencës, dhe integritetit të punës së autoriteteve publike.

Objektivi specifik 4.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues lidhur me integritetin e zyrtarëve, por edhe të kodit zgjedhor apo ligjit për partitë politike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Vitet e fundit institucioni është angazhuar intensivisht për realizimin e përmirësimeve të legjislacionit lidhur me integritetin e zyrtarëve por edhe të kodit zgjedhor, duke paraqitur propozime konkrete. Ky proces ka mbajtur në konsideratë problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të tij, por edhe sugjerimet/propozimet e vazhdueshme të grupeve të interesit.

Të dy këto akte ligjore që duhet të përmirësohen kanë për qëllim duhen parë edhe në optikën e plotësimit të kuadrit ligjor me dispozita që garantojnë integritetin e figurës së personave që dëshirojnë të ushtrojnë funksione të larta shtetërore.

Autoriteti vlerëson se këto përmirësime do të ndikojnë ndjeshëm në aksesin më të madh të subjekteve në informacionin/dokumentacionin e ish Sigurimit.

Përmbushja e këtij objekti do të realizohet nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- Miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- Miratimi i projektligjit “Për disa ndryshime në Kodin Zgjedhor”.
- Miratimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr 8580/2000 “Për Partitë Politike”.
- Forcimi i kapaciteteve të stafit të Autoritetit mbi zbatimin efektiv të kuadrit të ndryshuar ligjor dhe ofrimi i mbështetjes praktike për autoritetet publike mbi zbatimin e kuadrit të ri rregullator të fushës.

Objektivi specifik 4.2 - Përmirësimi i procedurave të ndjekura për verifikimin e subjekteve, për ta bërë procesin lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm për institucionin; të krijojë bazën e të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara, informacionet për strukturat operative ose bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit.

Ky objektivi është rrjedhojë e iniciativave ndërgjegjësuese, njohjes me të mirë të legjislacionit dhe besimit të shtuar në veprimtarinë e ushtruar nga institucioni.

Autoriteti do të vijojë fushatat e ndërgjegjësimit me faktorët relevantë, me agjencitë qeveritare dhe partitë politike për të sqaruar procesin e verifikimit dhe t’u përcaktojë atë si një normë për vitet e ardhshme. Nëse njëra palë e përdor shërbimin për të demonstruar pastërtinë e saj, ndërsa një tjetër e shmang atë nga frika e mosplotësimit, dosjet rrezikojnë të bëhen të politizuara.

Veprimi		Treguesi
1.	Krijimi i partneritetit me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve për të vëzhguar procesin e verifikimit si dhe çdo agjenci tjetër e përshtatshme që shpjegojnë vlerën e mundshme të verifikimit.	Marrëveshja, marrëveshjet e partneritetit.
2.	Përmirësimi i procedurave për verifikimin e kandidatëve, duke përfshirë përcaktimin e informacionit që mund të përfshihet në raportet dhe formatin e prezantimeve të raportit.	Politika e plotë e verifikimit.
3.	Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues lidhur me integritetin e zytrëve por edhe të kodit zgjedhor apo ligjit për partitë politike në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Propozime të qarta bazuar në problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të ligjit.
4.	Përditësimi dhe publikimi i formularit formal të kërkesës për verifikim dhe shpërndarja në agjencitë e përshtatshme për përdorim.	Formularët e kompletuar dhe të shpërndarë.
5.	Organizimi i fushatave publike dhe takimeve me agjencitë dhe subjektet politike. Nëpërmjet njoftimeve publike, bëhet e qartë se Autoriteti ofron informacione, por nuk përcakton pasojat.	Fushata publike dhe takimi me agjencitë dhe partitë e prekura.
6.	Ngritja e vetëdijes për të gjitha agjencitë e mundshme të përdoruesve dhe partitë politike për atë se çfarë mund dhe nuk mund të bëjë ky shërbim.	Lista e takimeve dhe ngjarjeve për ngritjen e vetëdijes; Regjistri i përdorimit të këtij shërbimi, sipas agjencisë kërkuese, partisë dhe individit.

Objektivi strategjik 5. Deklasifikimi i të gjitha dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të parashikuara në këtë ligj për periudhën 29 nëntor 1944 deri në ditën e krijimit të Shërbimit Informativ Kombëtar, 2 korrik 1991, të cilat disponohen nga të gjitha arkivat e rrjetit arkivor të Republikës së Shqipërisë.

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, Kuvendi i Shqipërisë në dispozitën përkatëse nenin 44 të ligjit ka ngarkuar Autoritetin me përgjegjësi të shtuara, zbatimi i të cilave do të sjellë edhe përmirësimin e punës dhe efektivitetin në dhënien e shërbimeve subjekteve kërkuese,

Realizimi i këtij procesi është në harmoni me një nga pikat projekt-rezolutës së Parlamentit Europian mbi raportin e komisionit të vitit 2022 për Shqipërinë ku theksohet – “Pajtimi dhe marrdhëniet e fqinjësisë së mirë – Nevoja për përfundimin e procesit të deklasifikimit të dosjeve të epokës së komunizmit dhe bërjen e tyre të aksesueshme për studiuesit dhe publikun e gjerë me qëllim avancimin e drejtësisë dhe pajtimit”.

Ligji nr 45/2015, i ndryshuar, i harmonizuar me ligj in nr. 10/2023 “Për Informacionin e Klasifikuar, përjashton nga aplikimi i kësaj dispozite, ato dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit që lidhen me marrdhëniet ndërmjet shteteve dhe sigurinë kombëtare. Pra deklasifikimi i dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nuk do të çënojë në asnjë rast marrdhëniet që Republika e Shqipërisë ka ndërtuar me shtetet e tjera, si dhe do të sigurojë ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurisë kombëtare.

Në secilën vendimarrje, Autoriteti duhet të mbrojë interesat e individit/individëve, interesat e shtetit (Siguri Kombëtare/Sekret shtetëror) si dhe interesat publike. Prandaj kërkohet një bashkëpunim ndërinstitucional sidomos me institucionet misioni parësor i të cilëve është mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe marrdhëniet ndërkombëtare me qëllim realizimin brenda kornizave ligjore të këtij procesi.

Objektivat do të realizohen nëpërmjet: Identifikimit të tipologjive të dokumentacionit apo fondit arkivor të ish Sigurimit të Shtetit, që sipas ligjit mund të vlerësohet se çojnë ose mund të çënojnë sigurinë kombëtare me qëllim kufizimin, përjashtimin nga deklasifikimi të dokumenteve të ish Sigurimit, dhënia, shfrytëzimi, ekspozimi apo bërja publike e të cilave do të përbënte çënim për sigurinë kombëtare;

- Identifikimin e rasteve kur interesat kombëtare mund të prevalojnë duke detyruar kryerjen e procesit të deklasifikimit të dokumentacionit arkivor edhe nëse ky deklasifikim mund të zbulojë identitetin e një burimi konfidencial;
- Deklasifikimin sipas listës së inventarëve të dokumenteve, dhe shenjëzimin sipas radhës së përparësisë;
- Bashkëpunimin e ngushtë me institucionet përgjegjëse të përfshira.

Në harkun kohor 2023-2028 parashikohet të përfundojë procesi i deklasifikimit të fondeve arkivore që disponon arkivi i Autoritetit duke përfshirë edhe aktet ligjore që e finalizojnë këtë proces te cilat janë; relacionet me propozimet mbi dokumenteve për deklasifikim, vendimet për dokumentet e deklasifikuara, bibliografitë dhe publikimet në faqen e Autoritetit, Qëndrën e Botimeve Zyrtare dhe Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

Objektiv specifik 5.1. Deklasifikimi sipas listës së inventarëve të dokumenteve, dhe shenjzimin sipas radhës së përparësisë.

Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë përcaktojnë rregullat bazë për organizimin, funksionimin dhe punën në arkivat në veprim të subjekteve shtetërore dhe joshtetërore, në arkivat tekniko-shkencore dhe në arkivat në figurë e në zë.

Përpunimi i të dhënave është një proces i cili lehtëson procesin e evidentimit për më shumë të dhëna, për qasjen dhe shërbimin e dokumenteve arkivore. Arkivistët ruajnë autenticitetin (vërtetësinë) e dokumenteve gjatë përpunimit, ruajtjes dhe shfrytëzimit. Mbi të gjitha, arkivistët zbatojnë disa parime unike të arkivistikës

Për dokumentet të cilat janë të papërpunuara, apo për dokumente të cilat kërkojnë ndarjen tematike sic janë dosjet O.R.V.(objekti i rëndësisë së veçantë), dosje të problemit të centralizuar, seleksionimi i urdhërave apo vendimeve etj, organizohet puna për përpunimin tekniko-shkencor. Paralelisht me përpunimin e fondeve arkivore krijohen edhe mjetet e reja të kërkimit.(kërkimin tematik, kërkimin në bazë pseudonimi, kërkimin individual etj)

Gjatë digjitalizimit të dosjeve, në metadatën e përcaktuar bëhet përshkrimi i dosjes me 5-6 fjali, për të dhën kontekstin që përmban dosja, dokumentet e hartuara në dosje, vitin që janë krijuar etj.

Veprimi		Treguesi
1.	Përcaktimi i tipologjive të dokumentacionit që sipas ligjit mund të vlerësohet nga Autoriteti dhe institucionet e tjera se bërja publike e tyre do të përbënte cënim për sigurinë kombëtare.	Dosje, fashikuj, regjistra, kartela, evidenca, libra, skedarë, shkresa etj.
2.	Krijimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese, dhe ato të rrejetit arkivor, brenda dhe jashtë vendit, që punojnë në këto drejtime.	Marrëveshje të Mirëkuptimit ose Letra të Bashkëpunimit.
3.	Krijimi i një komisioni të përbashkët me institucionet e tjera për të realizuar procesin e deklasifikimit/kufizimit të materialeve arkivore të fondit arkivor.	Relacionet me propozimet mbi dokumenteve për deklasifikim, vendimet për dokumentet e deklasifikuara, bibliografitë dhe publikimet në faqen e Autoritetit, QBZ dhe AKSIK.

Objektiv specifik 5.2 Ndërtimi i një kartoteke me materiale arkivore fizike që i shërben kërkesave të qytetarëve dhe studiuesve të rëndësishme për studimin e veprimtarisë së Sigurimit, gjatë periudhës komuniste në Shqipëri dhe sundimit totalitar në përgjithësi.

Veprimi		Treguesit
1	Hartimi i nje Plani Pune për ngritjen dhe shfrytëzimin e kartotekës dhe evidencës.	Plani i punës i dokumentuar dhe zbatimi i tij.
	Sistemimi i dokumentacionit të kartotekës dhe evidences: - inventarizimi, - administrimi - ruajtja e tyre sipas akteve ligjore.	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatimi i planit të punës ku parashikohet që materialet arkivore të cilat do të grumbullohen, administrohen, ruhen dhe shërbehen, duhet t'i nënshtrohen klasifikimit të tyre, sipas strukturës, degëve të veprimtarisë, sipas kriterit alfabetik. • Identifikimi, evidentimi dhe inventarizimi i dokumentacionit përkatës. • Inventarizimi nga grupi i punës i cili në përfundim të procesit do të hartojë një procesverbal nëpërmjet të cilit do të marrë në dorëzim, do të administrojë dhe do të ruajë materialet arkivore. • Krijimi i regjistër-inventarit fizik. • Krijimi i koleksioneve me materiale arkivore që lidhen me individë/familje/institucione, të cilat dokumentojnë një ngjarje apo periudhë historike të caktuar.
	Krijimi i mjeteve të reja fizike dhe elektronike për kryerjen e kërkimit.	Gjatë përpunimit të dokumentacionit, do të konceptohet edhe krijimi i mjeteve të reja të kërkimit në formë elektronike dhe shkresorë.

II.3 Objektivat e menaxhimit

Mandati i shtrirë i Autoritetit kërkon një gamë të gjerë të ekspertizës së stafit, nga njohuria e ligjit, historisë, politikës dhe letërsisë, në të drejtat e njeriut, deri tek aftësitë teknike në IT, ruajtjen e dokumenteve, shkenca bibliotekare dhe shtrirja e medias, secila fushë e veçantë e studimit me kredencialet e veta profesionale. Për të tërhequr dhe mbajtur një numër të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar, Autoriteti, bazuar në legjisllacionin e shërbimit civil, duhet të zhvillojë politika të qarta dhe progresive të personelit që inkurajojnë zhvillimin dhe iniciativën profesionale, bashkëpunimin brenda dhe përtej organizatës dhe angazhimin me publikun e gjerë. Këto politika dhe praktika duhet ta bëjnë Autoritetin një vend të dëshirueshëm për të punuar, ku stafi i ekspertëve mund të avancojë interesat profesionale gjatë shërbimit të misionit më të gjerë të institucionit.

Për të përmbushur misionet e tij të gjera dhe për të tërhequr punonjës të cilësisë së lartë, Autoriteti duhet të veprojë si organizatë kolegjiale dhe e decentralizuar, e cila bazohet në ekspertizën e anëtarëve të ndryshëm të stafit dhe u lejon atyre të veprojnë me një shkallë të lartë autonomie. Për dallim nga një strukturë drejtuese hierarkike apo piramidale, në të cilën personeli vepron duke kryer (përmbushur) vendimet e marra nga titullari, stafi i Autoritetit - duke përfshirë Anëtarët e Autoritetit prej pesë personash, stafin e Sekretariatit Teknik dhe ekspertë të tjerë - do të ketë lirinë e konsiderueshme individuale brenda fushave të tyre profesionale të ekspertizës. Për të ruajtur Autoritetin si organ profesional efektiv, do të krijohen protokolle të qarta për marrjen e vendimeve, bashkëpunimin në projekte dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë kolegjiale dhe jo hierarkike. Kjo sfidë menaxheriale kërkon balancimin e vendimmarrjes efikase me shpërndarjen e autoritetit ndërmjet ekspertëve të stafit.

Objektivi 1: Planifikim sa më efektiv në përputhje me vizionin e institucionit dhe bazuar në parimet e unitetit, vazhdimësisë, saktësisë dhe fleksibilitetit.

- Prioritizim i objektivave dhe masave konkrete në funksion të tyre, përcaktim i burimeve financiare dhe njerëzore të nevojshme dhe KPI (indikatoreve kryesorë të performancës) për çdo objektiv;
- Alokim i buxhetit sipas parimit të proporcionalitetit dhe menaxhimit me kosto-eficencë të burimeve financiare në dispozicion, me qëllim mbulimin sa më të mirë të nevojave të institucionit;
- hartimit të një plani për adresimin e rreziqeve të mundshme që mund të hasen gjatë veprimtarisë së Autoritetit dhe implementimit të këtij plani strategjik.

Parashikimi afat-mesëm buxhetor (3 vjeçar) është një element shumë i rëndësishëm për një planifikim sa më të mirë afat-shkurtër të veprimtarisë së institucionit.

Objektivi 2 - Përmirësimi i produktivitetit dhe performancës institucionale nëpërmjet:

- përdorimit sa më adekuat të BNJ dhe material në dispozicion dhe tërheqjes së kandidaturave më të mira për pozicionet e lira;
- një koordinimi më efikas të brendshëm midis strukturave të Autoritetit;
- bashkëpunimit sinergjik me organizata/institucione të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare;
- qasjes pro-aktive të menaxhmentit për një zhvillim profesional të burimeve të brendshme dhe promovimit për individët me ecuri të mirë dhe me eksperiencë të konsiderueshme në institucion por edhe më gjerë;
- Hartimit të Manualit të Procedurave Standarte të Punës për çdo funksionalitet të institucionit;
- Aplikimit të çdo mundësie alternative insentivuese për stafin, në funksion të rritjes së shkallës së motivimit.

Objektivi 3 –Përdorimi i asetëve për ndërtimin e partneriteteve dhe burimeve

Përveç personelit, Autoriteti ka nevojë për burime kur është fjala për të arritur qëllimet e tij. Fushatat e mediave, konferencat e hulumtimeve dhe botimet, ruajtja e dokumenteve dhe ekspozitat - të gjitha kërkojnë fonde të mjaftueshme dhe reputacion të fortë. Autoriteti duhet t'i kushtojë kohë dhe burime të stafit të tij mbledhjes së fondeve arkivore.

Ndërthurja e burimeve të tjera të financimit - siç janë grantet - mund të ndihmojë gjithashtu që Autoriteti të ketë pavarësi të mjaftueshme për të qenë në gjendje të iniciojë projekte dhe partneritete kur lindin mundësi. Çelësi për këtë përpjekje për ngritjen e fondeve do të jetë vendosja e partneriteteve me universitetet vendore dhe ndërkombëtare, fondacionet, OJF-të, organizatat e të drejtave të njeriut dhe agjencitë financuese.

Këto marrëdhënie, jo vetëm që mund të çojnë në financime të reja; ato mund të rrisin reputacionin e Autoritetit si një qendër rigoroze për promovimin e kërkimit, të drejtave të njeriut dhe ndërgjegjësim-it publik. Reputacioni i shtuar që vjen nga një pozitë më e mirë ndërkombëtare do të ndihmojë në rritjen e mundësive për financim, e cila do të kontribuojë në shtrirje më të madhe - një rreth i virtutshëm.

Veprimi		Treguesi
1.	Vendimmarrja nëse do të krijohet një sektor apo do të behet mbledhje fondi.	Sektori i themeluar dhe personeli i punësuar; Ose deklaratë të qartë të përgjegjësive të ngritjes së fondeve të stafit të Autoritetit.
2.	Themelimi i marrëdhënieve me universitetet e jashtme, OJF-të dhe agjencitë vendore dhe ndërkombëtare.	Memorandume të Mirëkuptimit (MoUs) ose marrëveshje të tjera të partneritetit.
3.	Ngritja e fondeve të jashtme për të plotësuar nevojat.	Fondet e ngritura nga entitete të jashtme.
4.	Ngritja e profilit të Autoritetit në vend dhe në rang ndërkombëtar.	Regjistrimi i përdorimit dhe citimit të burimeve të Autoritetit dhe ekspertizës nga organizatat ndërkombëtare.

II.4 Buxhetimi

Buxhetimi i këtij plani strategjik u realizua pas një procesi analize duke vlerësuar performancën e kaluar buxhetore dhe njëkohësisht të mjediseve e brendshme dhe të jashtme në të cilat operon Autoriteti. Kjo analizë mundësoi përfaqsimin buxhetore të këtij plani strategjik. Për të siguruar disponueshmërinë e burimeve financiare të përshtatshme për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve të planifikuara është menduar dhe formulimi dhe zbatimi i një strategjie për mobilizimin e burimeve e specifikuar në planin e veprimit.

Gjatë Buxhetimit të Planit strategjik u mbajtën parasysh masat prioritare të mëposhtme:

1. Rritja e kapacitetit organizativ, efektivitetit dhe efikasitetit;
2. Tërheqja, zhvillimi dhe forcimi i burimeve njerëzore të aftë dhe produktive;
3. Forcimi i menaxhimit dhe përfshirja e palëve të interesuara;
4. Forcimi i kapaciteti financiar të Autoritetit;
5. Sigurimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës dhe aseteve të duhura;
6. Zbatimi i proceseve dhe procedurave efikase dhe efektive;
7. Adoptimi i TIK-ut në procese të ndryshme;
8. Disiplinë e rreptë financiare;
9. Zhvillimi dhe funksionalizimi i kornizës së menaxhimit të rrezikut.

Kështu, sigurimi i burimeve financiare të nevojshme është menduar nga disa burime, sikurse janë mbështetja nga Qeveria, partnerët Autoritetit, dhe aktorë të tjerë. Mënyrat e sigurimit të burimeve financiare do të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a. Angazhimi i Qeverisë për rritjen e buxhetit të Autoritetit;
- b. Angazhimi i Komisioneve Përkatëse Parlamentare;
- c. Identifikimi dhe angazhimi i partnerëve të mundshëm;
- d. Angazhimi dhe partneriteti me Organet e Vetëqeverisjes Vendore;
- e. Angazhimi dhe partneritetet me Organizata dhe Institucione ndërkombëtare dhe vendase.

Totali i fondeve/tavaneve të miratuara për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2024 - 2026, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 195 datë 05.04.2023 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, në vitin 2024 janë 117,100 mijë lekë, në vitin 2025 janë 117,100 mijë lekë dhe në vitin 2026 janë planifikuar në vlerën 118,100 mijë lekë.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zbaton një program të vetëm buxhetor “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”.

Buxhetimi i planifikuar nga Autoriteti për periudhën 2024-2028, referuar tavaneve buxhetore edhe kërkesave shtesë të identifikuar për vitet 2024-2025-2026, ndërsa për 2027 dhe 2028, është bërë një projeksion i përafërt nga ana jonë.

Mijë lekë

Planifikimi i buxhetit per periudhen 2024-2028							
2024		2025		2026		2027	2028
T a v a n i buxhetor	K ë r k e s a shtesë	T a v a n i buxhetor	K ë r k e s a shtesë	T a v a n i buxhetor	K ë r k e s a shtesë		
194,500	76,918	117,100	62,446	118,100	57,704	179,100	179,100

II.5 RISQET POTENCIALE DHE ADRESIMI I TYRE

Kufizimet buxhetore te vendosura nga MF.

- Ky lloj risku do te adresohet pjeserisht nga perpjekjet per te siguruar financime nga pale te treta (donator te mundshem), per komponente te caktuar te veprimtarise së Autoritetit;
- Një mënyrë tjetër mund të jetë edhe rishikimi i planit të veprimit, duke bërë një priorizim të aktiviteteve, referuar objektivave strategjikë;
Ekspertizë e pamjaftueshme e burimeve të brendshme të institucionit, për procesin e hetimit dhe identifikimit të personave të zhdukur nga periudha komuniste;
- Rishikim i kriterëve profesionale të pozicioneve aktuale të punës në Dr. e të Zhdukurve ose adresim i nevojave me specifike me BNJ outsource.

Lëvizshmëri e BNj si rezultat i gjetjes së mundësive më të mira sin ë aspektin e zhvillimit profesional ashtu edhe të shpërblimit financiar;

- Ky lloj risku me të cilin jemi përballur edhe gjatë implementimit të planit strategjik pararendës mund të zbutet si pasojë e reformës në sistemin e pagave në administratën publike, ku me hyrjen në fuqi të VKM 325, datë 31.05.2023, shpërblimi financiar për punonjësit ka pësuar një hop të ndjeshëm. Deri në fund të vitit 2024, do të ketë edhe një rritje tjetër kryesisht, për punonjësit e kategorisë ekzekutive.
- Një mundësi tjetër për adresimin e këtij problemi është edhe stimulimi i burimeve njerëzore ekzistuese nëpërmjet ndjekjes së trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të rritjes profesionale, por edhe mundësimit për ngritje në detyrë për punonjësit me experiencë të konsiderueshme në fushën e tyre të komptencës por edhe të lidhur me performancën e tyre në Autoritet.

Vonesa gjatë shqyrtimit të dokumenteve që do të kalojnë procesin e deklasifikimit që lidhen më sigurinë kombëtare dhe marrdhëniet diplomatike.

- Ky lloj risku mund të zbutet nëpërmjet zbatimit të vazhdueshëm të marrëveshjes së përbashkët me SHISH, e cila konsiston në bashkëpunimin për vlerësimin paraprak lidhur me cënimin e sigurisë kombëtare, gjatë procesit të deklasifikimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe asistencë e tyre në këtë proces mbi analizimin e dokumenteve, në funksion të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të tyre.

Ndryshimet ligjore të Ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, të cilat mund të sjellin vështirësi në procesin e grumbullimit dhe administrimit të dokumenteve arkivore.

- Ky lloj risku mund të zgjidhet me marrëveshje bashkëpunimi ngushtë me institucionet përgjegjëse të përfshira.
Spontaniteti mbi 30 vjeçar që ka sunduar procesin me përpjekje vetëm individuale të familjarëve të ekzekutuar, vrarë apo dhe vdekur në burgjet e komunizmit.
- Ky lloj risku do ulet nga ligjshmëria dhe serioziteti me të cilin do trajtojmë procesin, duke dokumentuar shkencërisht gjendjen dhe hapat që do hedhim, gjithnjë në bashkëpunim me familjarë të të zhdukurve, si dhe me institucionet që ligji dhe aktet nënligjore i ngarkojnë me përgjegjësi në proces.

Agresioni i madh që i është bërë territorit gjatë tranzicionit, shoqëruar me moszgjidhjen e çeshtjeve të pronësisë.

- Ky risk mendojmë që do ulet me insistimin e vazhdueshëm dhe bashkëpunimin me organet e qeverisjes vendore, me qëllim ndërprerjen (e nëse ka mundësi edhe prapësimin) e akteve që mund të kenë përkeqësuar apo tjetërsuar vendvarrime të personave të zhdukur.

Frika apo pasiguria për të bashkëpunuar, e personave që kanë dijeni për rrethana të zhdukjes së personave, vendvarrimit të tyre, etj

- Ky risk mendojmë që do ulet me përpjekjen edhe të drejtorive të tjera në Autoritet, përmes sensibilizimit popullor, për të vërtetën e qëllimit të punës sone që nuk synojmë të dënojmë fajësinë se sasa të nderojmë pafajësinë.

KREU III - ZBATIMI, RAPORTIMI, MONITORIMI DHE LLOGARIDHËNIA

III.1 Institucionet përgjegjëse

Plani Strategjik 2023-2028 synon koordinimin e veprimtarive të ndryshme në përmbushje të kompetencave të Autoritetit që burojnë nga ligji nr. 45/2015, i ndryshuar, si dhe nga korniza ligjore në fuqi. Autoriteti është institucioni përgjegjës për zbatimin e Planit Strategjik 2023-2028.

Ky Plan Strategjik synon të krijojë kushtet për ndërveprimin e Autoritetit me institucione të tjera dhe përfshirjen në procese të ndryshme të karakterit ligjor dhe shoqëror, me qëllim krijimin e kushteve për një bashkëpunim pozitiv ndërmjet aktorëve përgjegjës për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar

Për këtë, nuk mjafton vetëm forcimi i kapaciteteve të Autoritetit si në nivel drejtues ashtu edhe administratës së tij, por edhe ndërgjegjësimi i aktorëve që ndërveprojnë me të. Kështu Ministri përgjegjës për punët e brendshme, Ministri përgjegjës për çështjet sociale, dhe Ministri përgjegjës për

arsimin apo për Kulturën kanë fusha të përbashkëta tek të cilat mund dhe duhet të rrisin bashkëpunimin. Një tjetër aktor i rëndësishëm mund të gjendet pranë pushtetit vendor, me qëllim bashkëpunimin për identifikimin dhe rikuperimin e ehstave të personave të zhdukur gjatë rregjimit komunist apo për krijimin e varrezave përkujtimore. Përveç institucioneve publike, një potencial me vlerë për zbatimin e ligjit gjendet tek Organizatat e Shoqërisë Civile vendase dhe të huaja të cilat adresojnë çështjes e së drejtës së informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit ose të drejtësisë tranzicionale në mënyrë të drejtpërdrejtës ose të tërthortë. Për këtë synohet mbajtja e një rrjeti aktiv partneriteti mes Autoritetit dhe këtyre organizatave. Përveç sa më sipër, bashkëpunimi me institucionet akademike dhe universitetet shihet si një marrëdhënie e Autoritetit me përfitim të dyfishtë sepse përveç zbatimin të legjislciaonit në fuqi në mënyrën më të plotë synohet edhe thithja e ekspertizës, ideve, dhe argumenteve shkencore nga bota akademike, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së Autoritetit-së në një nivel sa më lartë.

III.2 Mekanizmat e monitorimit

Në mënyrë që ky plan strategjik të mbetet koherent dhe të përqendrohet tek zbatimi i arritjeve dhe sfidave, ai duhet të rishikohet dhe të përditësohet vazhdimisht. Përveç kësaj, plani strategjik duhet të përkthehet në instrumente vjetore të planifikimit që janë më specifike dhe më të përshtatshme për t'u ndryshuar dhe korrigjuar. Planet vjetore që do të hartohen si pjesë e zbatimit të strategjisë përfshijnë më shumë aktivitete të detajuara dhe më shumë tregues që korrespondojnë me burimet e brendshme (kryesisht njerëzore dhe financiare) dhe burimet e jashtme (përfshirë rrjetëzimin dhe financimin e huaj).

Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit do të jetë koordinator për monitorimin dhe vlerësimin e tij si dhe për të hartuar mjete më specifike për monitorimin dhe vlerësimin, për të hartuar dhe kryer aktivitete monitoruese për aktivitete specifike dhe qëllimet strategjike, për të këshilluar lidhur me procesin e nxjerrjes së përfundimeve mbi rezultatet, dhe për caktimin ose rishikimin e objektivave dhe aktiviteteve të reja për fazat ose periudhat e ardhshme të zbatimit dhe për detyrat e tjera që do të identifikohen gjatë procesit. Anëtarët e Autoritetit dhe Kryetari i tij do të jetë gjithashtu përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe udhëzimin e procesit të monitorimit, si dhe për shkëmbimin e të dhënave brenda institucionit, ose marrjen e informacionit të nevojshëm nga institucionet e tjera, duke i deleguar detyra specifike koordinatorit dhe drejtuesve të departamenteve.

III.3 Raportimi i progresit

Në këtë drejtim, procesi do të përqendrohet kryesisht në nivelin e arritjes së suksesit të rezultateve të planifikuara, duke matur veprimet kyçe, dhe duke ruajtur një këndvështrim drejt arritjes së të gjitha qëllimeve dhe objektivave strategjike.

Procesi i monitorimit do të përbëjë një proces të brendshëm të vazhdueshëm që përfshin sisteme efektive për mbledhjen e të dhënave për punën e bërë nga raportimi dhe takimet e strukturave drejtuese, kontributet e personelit dhe angazhimi i palëve të interesuara. Si pjesë e monitorimit, ky Plan Strategjik përfshin një kuadër logjik me:

- tregues sasiore dhe cilësore që përbëjnë bazën për monitorimin e progresit të secilit objektivi strategjik ose specific. Disa nga treguesit për matjen e performancës janë:
 1. Numri i faqeve të vëna në dispozicion nga hapja e dosjeve, në kohë dhe me cilësi
 2. Numri i ankesave
 3. Numri i kërkuese sipas objektit të tyre.
 4. Numri i dokumentave të dixhitalizuara;
- afatet e zbatimit për çdo veprim; këto duhet të ndahen në elementët më të rëndësishëm dhe afatet kohore për çdo veprim në procesin e planifikimit vjetor;
- parashikimin e burimeve financiare bazuar në vitet e mëparshme, intensitetin e veprimeve, si edhe përfshirjen e kërkesave të financuara brenda institucionit dhe kërkesave të pa financuara;
- një listë indikative të institucioneve përgjegjëse për zbatimin, duke përfshirë partnerët potencialë të financimit për aktivitete të veçanta të përbashkëta.

III.4 Vlerësimi i progresit

Vlerësimi i këtij Plani Strategjik parashikon tri lloje kryesore aktiviteteve: analizën vjetore, vlerësimin afatmesëm dhe vlerësimin e strategjisë përfundimtare. Analiza vjetore është procesi i vlerësimit të rezultateve vjetore për zbatimin e çdo plani vjetor të punës. Autoriteti do të hartojë plane vjetore pune që rrjedhin dhe janë në harmoni me qëllimet, objektivat dhe Kreu III. Procesi i analizës vjetore do të përfshijë një analizë të objektivave dhe rezultateve në krahasim me situatën aktuale.

Analiza afatmesme është procesi i vlerësimit të progresit në zbatimin e strategjisë përkundrejt qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në planin strategjik, si dhe rezultateve dhe arritjeve të arritura gjatë dy analizave të para vjetore. Rezultati përfundimtar i analizës afatmesme do të jetë plani strategjik i përditësuar, duke reflektuar mbi arritjet, sfidat dhe ndryshimin e kontekstit.

Vlerësimi përfundimtar i strategjisë do të vlerësojë arritjen e përgjithshme të rezultateve të parashikuara në Planin Strategjik dhe do të identifikojë rezultatet dhe ndryshimet që mund të lidhen me zbatimin e tij. Për të siguruar objektivitetin dhe për të garantuar paanshmërinë e pikëpamjeve dhe mendimeve, vlerësimi përfundimtar mund të kryhet nga ekspertë të jashtëm me përvojë në vlerësim, të mbështetur nga një ekip profesionistësh të caktuar nga vetë institucioni.

Raportet përfundimtare nga analiza afatmesme dhe nga vlerësimi përfundimtar i strategjisë do të miratohen nga Autoriteti.

Autoriteti do të emërojë një grup pune të përbërë nga drejtuesit e departamenteve dhe të drejtuar nga Sekretari i Përgjithshëm për realizimin e detyrimeve që burojnë nga ky Kre i Planit Strategjik.



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT